# GAZETA SHQIPTARE






Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIII - Nr. 7613 E martë 7 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)





Opinioni i Ditës

Nga MONIKA STAFA

## 'Fake News' - Lufta mes së mirës dhe së keqes



Presidenti amerikan Barak Obama ishte ndër të parët liderë botërorë, i cili shqiptoi me vetëdije të plotë shqetësimet që po tronditnin botën prej përhapjes së...

Vijon në faqen 21



Opinioni i Ditës

Nga JORGJI KOTE

## Referim i gabuar

Sikur të mos mjaftonte vala e të nxehtit saharian në këtë gusht pushimesh, Presidenti i Kosovës, zoti Hashim Thaçi, i ngriti sa nuk ka ku shkon edhe...

Vijon në faqen 20



Kryeministri: 'S&P' konfirmon zhvillimin ekonomik

# Edi Rama nxjerr raportin: Shqipëria pritet të ketë rritje të qëndrueshme

PD: Ndal qeverisjes 'Rama', rrezikojmë skenarin më të keq. Pas 202 vitesh arrihet e mesmja europiane

Kryeministri Edi Rama publikoi dje konkluzionet e raportit të agjencisë prestigjioze të vlerësimit të ekonomisë "Standard and Poor's", duke thënë se është konfirmuar rritja. Duke iu përgjigjur komentuesve që ankohen për gjendjen e vështirë me të cilën përballen e gjithashtu edhe kritikave për politikat që po ndjek qeveria e tij, Rama u shpreh: "Shqipëria...

Në faqet 2-3

ATP PUBLIKON REGJISTRIN PER 12 QARQET: JA KUJT U ESHTE NJOHUR E DREJTA

# PRONARET, KOMPENSIMI PER DOSJET E 2001-2013

Përfitojnë 3700 persona. Lista e re e Agjencisë së Trajtimit të Pronave: Shuma e parave që merr secili. Tri afatet për shlyerjen e pagesave të përshpejtuara



*(Në foto)* Foto ilustruese

Në faqet 7-9

BAZA E NATO-s

## Koçi: Dëshmon peshën e Shqipërisë për sigurinë në rajon, investim me rëndësi

Në faqen 4

U KONFIRMUA NE DETYRE

## ONM rekomandon apelimin e vendimit të KPK-së për Xhezair Zaganjorin

Në faqen 5

NGJARJA

## Tronditen banorët e Vlorës, përplasje me armë zjarri pranë universitetit

Në faqen 6

FITUESIT E RAUNDIT TE PARE

## Zbardhen datat për aplikimet dhe regjistrimet në universitete

Në faqen 11

KULTURE



## Luan Rama: Shqipëria, tokë ku shkelën perandorë

Në faqet 18-19

Veseli: Do hyjmë në OKB me kufijtë e pavarësisë. Nishani: Kosova është 'Jerusalemi' i shqiptarëve

# Thaçi: Propozimi për zgjidhje me Serbinë është i qartë

*Ish-zëvendësi i Ahtisarit: Do hapet 'kutia e Pandorës'. Jo ndarje e shkëmbim territoresh*

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, edhe një herë vazhdon të këmbëngulë në qëndrimin e tij në raport me bisedimet me Serbinë dhe idesë së propozuar prej tij. Përmes një postimi në rrjetin social "Twitter", ai thotë se propozimi i tij për një zgjidhje paqësore me Serbinë tashmë



është i qartë. "Propozimi im për një marrëveshje paqësore me Serbinë është i qartë. Nuk ka ndarje përgjatë vijave etnike, por në korrigjimin e kufirit dhe njohje reciproke", shkruan Thaçi. Ndonëse Thaçi deri vonë ishte kundër idesë për korrigjimin...

Në faqen 12

# EKONOMIA
## RAPORTI

Kryeministri: "Standard and Poor's" konfirmon zhvillimin ekonomik

# Rama nxjerr raportin: Shqipëria pritet të ketë rritje të qëndrueshme

## "Performanca fiskale është përmirësuar"

Kryeministri Edi Rama publikoi dje konkluzionet e raportit të agjencisë prestigjioze të vlerësimit të ekonomisë "Standard and Poor's", duke thënë se është konfirmuar rritja. Duke iu përgjigjur komentuesve që ankohen për gjendjen e vështirë me të cilën përballen e gjithashtu edhe kritikave për politikat që po ndjek qeveria e tij, Rama u shpreh: "Shqipëria pritet të ketë një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe ka pak gjasa të pësojë zhbalancime fiskale ose të jashtme, gjatë tre a katër viteve të ardhshme". Sipas Ramës, performanca fiskale e vendit është përmirësuar ndjeshëm në vitet e fundit, mbështetur nga rritja e qëndrueshme ekonomike dhe nga një kuadër fiskal i përmirësuar, i cili tani përfshin edhe një frenim të formalizuar të deficitit (Ligji Organik Buxhetor). Ai citon agjencinë prestigjioze të vlerësimit të ekonomisë "Standard and Poor's", se njeh përpjekjet e qeverisë për të përmirësuar sundimin e ligjit dhe për të luftuar ekonominë informale, për të arritur statusin e kandidatit formal për pranimin në BE. "S&P parashikon që ecuria fiskale e Shqipërisë të mbetet pozitive deri në vitin 2021 dhe më e mirë se vendet me vlerësim të ngjashëm. Kjo si rezultat i pritshmërive pozitive të rritjes ekonomike dhe kontrollit të deficitit buxhetor nga qeveria", shkroi Rama në "Facebook". Kryeministri shprehet se ky përfundim s'ka nevojë për komente, pasi aty konfirmohet ecuria pozitive e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë. Pak ditë më parë ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj njoftoi këtë raport të "Standard and Poor's", duke thënë: "Sërish notë pozitive për ekonominë shqiptare". "Agjencia prestigjioze e vlerësimit, 'Standard and Poor's' jep një tjetër vlerësim pozitiv për ekonominë e Shqipërisë, duke konfirmuar notën 'B+', me perspektivë të qëndrueshme si ekonomike, ashtu edhe fiskale për periudhën në vijim", u shpreh Ametaj. Në raportin e publikuar më 3 gusht, "S&P vlerëson se performanca fiskale e vendit është rritur ndjeshëm në vitet e fundit, mbështetur nga rritja e qëndrueshme ekonomike dhe nga një kuadër fiskal i përmirësuar, i cili tanimë e ka vendosur detyrim në ligj kontrollin rigoroz të deficitit dhe uljen e tij, duke vendosur nën kontroll risqet e lidhur me të. Në të njëjtën kohë vlerësohet performanca në rritje e të ardhurave buxhetore, mirëadministrimi si rezultat edhe i uljes së informalitetit, kontrolli dhe ulja e shpenzimeve dhe vazhdimi i reformave strukturore nga ana e qeverisë, kryesisht ajo në sistemin e drejtësisë, të cilat pritet të reflektohen në një renditje më të lartë vitin e ardhshëm", u shpreh ministri i Financave.



Kryeministri Edi Rama

**ARBEN AHMETAJ**

Pak ditë më parë ishte ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj që njoftoi këtë raport të "Standard and Poor's", duke thënë: "Sërish notë pozitive për ekonominë shqiptare. Agjencia prestigjioze e vlerësimit 'Standard and Poor's' jep një tjetër vlerësim pozitiv për ekonominë e Shqipërisë, duke konfirmuar notën 'B+', me perspektivë të qëndrueshme si ekonomike, ashtu edhe fiskale për periudhën në vijim", u shpreh Ametaj.



S&P Global
Ratings

RatingsDirect®

Research Update:

DRAFT: Albania 'B+/B' Ratings Affirmed; Outlook Stable

Raporti i agjencisë "Standard and Poor's"

**KRYEMINISTRI**

"Shqipëria pritet të ketë një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe ka pak gjasa të pësojë zhbalancime fiskale ose të jashtme, gjatë tri a katër viteve të ardhshme. Performanca fiskale e vendit është përmirësuar ndjeshëm në vitet e fundit, mbështetur nga rritja e qëndrueshme ekonomike."



Gjatë një seance parlamentare

### "Ndërsa në Evropë restaurohet, këtu shkatërrohet"

## Vasili sulmon Veliajn: Gërmadhat provinciale që urrejnë Tiranën

Kryetari i grupit parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim, Petrit Vasili akuzoi dje kryebashkiakun e Tiranës, Erion Veliaj. Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", deputeti i LSI shkruan se ndërkohë që në Europë restaurohet çdo mur apo ndërtesë që mban gjallë memorien, kulturën e trashëguar dhe korpusin e vlerave intelektuale, në Shqipëri ato shkatërrohen. "Këta bulimistët politikë, që qeverisin Tiranën shkatërrojnë, me histeri të papërmbajtur. Këta të kompleksuarit tanë vuajnë dhe nuk shërojnë dot provincializmin e tyre arkaik, pa ngjyrë, pa moral dhe plot urrejtje për Tiranën; nuk bëhen e nuk bëhen dot qytetarë të saj", shkruan Vasili. "Gërmadhat provinciale, që qeverisin dhe urrejnë Tiranën! Tirana është një e tërë. Tirana ka qenë dhe mbetet përfaqësuese e atyre standardeve shoqërore, intelektuale dhe morale, që e lëvizin përpara vendin. Ç'janë këta kaqola, që na e shpifën me këto numra idiotësh jo 200 mijë andej po 800 mijë këndej. Këta gjithë ditën kanë pjesë të broçkullave të tyre krahasimin me Romën, Parisin, Londrën, Vjenën, Barcelonën etj., etj. Po kanë a dëgjuar këta kaqolët tanë ndonjëherë, që ata burra e gra të mençur dhe pa komplekse, që i drejtojnë ato qytete t'i ndajnë qytetet e tyre në 'kaq mijë njerëz na duhen dhe kaq nuk na duhen'. Idiotësira të tilla vetëm këta tanët në Tiranë mund t'i nxjerrin nga goja", shkroi dje kreu i grupit të LSI-së. "Këta 'budallenjtë' e Europës restaurojnë me merak e dashuri çdo metër mur apo ndërtesë, që mban gjallë memorien, kulturën e trashëguar dhe korpusin e vlerave intelektuale. Ndërsa këta bulimistët politikë, që qeverisin Tiranën shkatërrojnë, me histeri të papërmbajtur. Këta të kompleksuarit tanë vuajnë dhe nuk shërojnë dot provincializmin e tyre arkaik, pa ngjyrë, pa moral dhe plot urrejtje për Tiranën, nuk bëhen e nuk bëhen dot qytetarë të saj", tha Vasili. "Këta duke u hakmarrë ndaj Tiranës dhe duke shkatërruar trashëgiminë e saj, u duket sikur do shërojnë e qetësojnë komplekset e inferioritet e tyre, pa ditur se po i thellojnë ato. Ndaj Tirana i përbuz këta dhe përbuzjen nuk e përcaktojnë numrat, por gërmadhat provinciale të cilat Tirana i bluan, i flak dhe vetëpastrohet prej tyre, siç ka bërë në dhjetëra e dhjetëra vjet, nga ku ka dalë më e shndritshme dhe më e fortë, por edhe më e pastër…", e mbylli komentin e tij Vasili.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu:*** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu:*** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



### Deputetja Duma sulmon qeverinë për varfërinë: 1.7 milionë shqiptarë jetojnë në varfëri

# PD: Ndal qeverisjes "Rama", rrezikojmë skenarin më të keq

## *"Pas 202 vitesh arrihet e mesmja europiane"*

Valentina Madani

Partia Demokratike akuzoi dje qeverinë si shkaktare të gjendjes së rënduar ekonomike, e cila ka çuar në rritjen e nivelit të varfërisë në vend. "Duke iu referuar shifrave për vitin 2018, në raportet e Eurobarometrit dhe Barometrit për Ballkanin, opozita shprehet përmes sekretares Grida Duma se papunësia dhe korrupsioni vijojnë të jenë dy nga shkaqet kryesore që kanë ndikuar në përkeqësimin e jetës së shqiptarëve. Eurobarometri i 2018-ës për Shqipërinë fakton që 1 milionë 750 mijë shqiptarë deklarojnë që gjendja e tyre ekonomike është plotësisht e keqe. Po ashtu, Eurobarometri tregon se për 67% të shqiptarëve papunësia është problemi më i madh i tyre. Një tjetër raport i rëndësishëm, Barometri për Ballkanin tregon se 51% e shqiptarëve deklarojnë se janë të përjashtuar nga shoqëria se nuk gjejnë dot punë. 48% e shqiptarëve deklarojnë që problemin më të madh me korrupsionin e kanë në shëndetësi, spitale dhe ilaçe". Por, Partia Demokratike përmes sekretares së Marrëdhënieve me Publikun, Grida Duma bëri dje përgjegjëse qeverinë "Rama" për rritjen e nivelit të papunësisë në vend. Sipas Dumës, një numër më i madh shqiptarësh kanë deklaruar se gjendja e tyre ekonomike është më e përkeqësuar këtë vit krahasuar me një vit më parë, referuar shifrave të Eurobarometrit të BE-së. Deputetja e PD-së, Grida Duma lexoi shifrat e raportit të Eurobarometrit të 2018 për Shqipërinë, sipas të cilit 1 milion 750 mijë shqiptarë deklarojnë që gjendja e tyre ekonomike është plotësisht e keqe. "Eurobarometri, matësi i Bashkimit Europian për ecurinë e vendeve europiane dhe të Ballkanit Perëndimor po konfirmon vit pas viti përkeqësimin e treguesve të zhvillimit të Shqipërisë. Tri problemet më të mëdha për shqiptarët janë ekonomia, papunësia dhe korrupsioni. Eurobarometri i 2018-ës për Shqipërinë fakton që 1 milion 750 mijë shqiptarë deklarojnë që gjendja e tyre ekonomike është plotësisht e keqe. Vetëm në një vit, pra midis 2017 dhe 2018 janë shtuar 245 mijë shqiptarë më shumë, që deklarojnë se gjendja e tyre ekonomike është shumë e keqe. Po ashtu, Eurobarometri tregon se për 67% të shqiptarëve papunësia është problemi më i madh i tyre. Në një vit të vetëm janë 315 mijë shqiptarë që e deklarojnë gjendjen e tyre shumë më keq. Këto nuk janë shifra, por jetë njerëzish që përkeqësohen, jo në dhjetë e njëqind, por me qindra mijëra", deklaroi zj.Duma. Sipas saj, shqiptarët fatmirësisht besojnë ende se zgjidhja është BE. "Por shqiptarët fatmirësisht vijojnë të besojnë se hyrja në BE është zgjidhja. Madje, besimi se BE është shpëtimi është rritur me 2% brenda një viti dhe 90% e shqiptarëve kanë këtë qëndrim", tha Duma. PD deklaron se është jetike të ndalohet qeverisja e Ramës. "Është jetike një tjetër qeverisje, përndryshe rrezikojmë të ndodhë skenari më i keq për shqiptarët, ai që parashikon BERZH. Në këtë skenar theksohet se nëse vazhdohet me këto shifra në rënie, shqiptarët do të arrijnë mesataren europiane në vitin 2220. Është jetike të ndalojmë qeverisjen kundër shqiptarëve, kundër mirëqenies që shtyn të ardhmen me qindra vite", deklaroi deputetja e PD-së, Grida Duma.



Sekretarja e Marrëdhënieve me Publikun, Grida Duma

**SKENARI**
Deputetja Duma lexoi shifrat e raportit të Eurobarometrit të 2018-ës për Shqipërinë, sipas të cilit 1 milion 750 mijë shqiptarë deklarojnë që gjendja e tyre ekonomike është plotësisht e keqe. "Është jetike një tjetër qeverisje, përndryshe rrezikojmë të ndodhë skenari më i keq për shqiptarët, ai që parashikon BERZH", tha Duma.

### Deputetja e PD: Çdo ditë mbyllen 45 biznese

## Tabaku: Taksat e larta po i marrin "shpirtin" sipërmarrjes

Deputetja demokrate dhe zv.kryetarja e Komisionit të Ekonomisë në Kuvend, Jorida Tabaku akuzoi dje qeverinë "Rama" për klimën e rënduar të biznesit dhe sipërmarrjes në Shqipëri. Tabaku shkruan se çdo ditë mbyllen 45 biznese dhe në total gjatë 6-mujorit të parë të këtij viti janë mbyllur 66% më shumë biznese se një vit më parë. Sipas saj, është një krizë që po përndjek bizneset në Shqipëri. "45 biznese në ditë janë mbyllur këtë vit. Ka një krizë që po përndjek nga pas bizneset në Shqipëri, një krizë që nuk po i lë të ngrenë kokë bizneset që vazhdojnë të mbyllen përditë e më shumë. Të dhënat janë kokëforta dhe në katër vjet janë mbyllur 68,731 biznese, ndërsa qeveria përkujdeset që të shmanget nga ky debat esencial. Vetëm gjatë këtij 6-mujori janë mbyllur 66% më shumë biznese se në 2017-ën. Janë 45 biznese në ditë që mbyllen si pasojë e taksave të larta, që u marrin gjithnjë e më shumë para nga arka, për të mos u kthyer asgjë në këmbim. Sipërmarrësit rrëfejnë presionet e qeverisë, ndërsa bizneset e tyre janë në krizë nga rënia e konsumit, nga rënia e fuqisë blerëse, që çdo ditë e më shumë po tregon se ekonomia lëngon. Qeveria është kundër sipërmarrjes së lirë dhe të ndershme, e angazhuar që në fillim për t'ua marrë shpirtin dhe për t'i dënuar me taksim të lartë. Sot jemi më të varfër dhe më të taksuar se sa katër vjet më parë. Ky ishte plani i rilindjes dhe fatkeqësisht sot ky është realiteti", shkruan Tabaku në "Facebook".




**DENONCIMI**
Deputetja Tabaku akuzoi qeverinë "Rama" për klimën e rënduar të biznesit dhe sipërmarrjes në Shqipëri. Tabaku shkruan se çdo ditë mbyllen 45 biznese dhe në total gjatë 6-mujorit të parë të këtij viti janë mbyllur 66% më shumë biznese se një vit më parë.



## Denoncimi te Berisha: Helikopteri i rrëzuar, me hashashin e Peleshit

Ish-kryeministri Sali Berisha vijon të publikojë në faqen e tij në "Facebook", mesazhe të qytetarëve të ndryshëm. Berisha dje publikoi një mesazh, sipas të cilit helikopteri i rrëzuar në Korçë nuk kishte pasur për qëllim marrjen e një nuseje, por qe i mbushur me hashash. "Kompania e Olsi dhe Gaz Ramës merret me transport droge! Sb 'Doktor sot tek ty desha të denoncoj se helikopteri që bëri ulje të detyruar në Korçë nuk ishte me dasmorë, por i mbushur me hashashin e Niko Peleshit, Fatmir Xhafajt dhe ish-dr. të bujqësisë dhe kumbarit të deputetit të PS-së në Pogradec, Vullnet Gjollës, ku nën diktatin e këtij të fundin e mbollën hashashin në tokat e bazës së bujqësisë në qytetin e Korçës, gjoja me pretekstin hashash industrial dhe këto të ardhura kanë për të blerë votat e Bashkisë Maliq se ky Vullneti është koordinator i PS dhe punonjës i lartë në Drejtorinë e Bujqësisë në Korçë dhe helikopteri ishte i kompanisë 'Shega Trans', mbas së cilës fshihet Olsi Rama me aksioner kryesor Gas Demin e Sport Klub 'Partizanit' se nuk kanë lekë korçarët të hanë bukë dhe jo më të marrin nusen me helikopter ok. Doktor Sali të lutem publikoje. Respekte, të urojmë jetë sa më të gjatë të kesh ti, miku ynë më i mirë", thuhet në mesazhin dërguar z.Berisha.

### Tritan Shehu: I gjithë rrugëtimi i Shqipërisë drejt NATO-s lidhet me PD

# Baza e NATO-s, PD: E mirëpritur, por qeveria të mos e përdorë si fishekzjarrë



Partia Demokratike ka reaguar për herë të parë pas vendimit të Këshillit të Atlantikut të Veriut, për të ndërtuar në Shqipëri bazën e parë ajrore në Ballkanin Perëndimor. Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", deputeti demokrat Tritan Shehu, nënkryetar i Komisionit të Jashtëm tha se, "çdo rritje e prezencës së NATO-s në Shqipëri është thellësisht e dëshiruar, stimuluar dhe mirëpritur nga ne, kjo është e shkruar në gjenet tona". Ai kujton se, "i gjithë rrugëtimi i Shqipërisë drejt NATO-s lidhet me PD, qeverisjet e saj, deri në anëtarësimin e plotë tonin aty. PD që me 'lindjen' e saj, ndryshe edhe nga partitë e tjera të krijuara në ish-bllokun komunist, konfirmoi vullnetin tonë për BE e NATO. Më tej, më qershor të 1992, pra dy muaj mbas formimit të qeverisë sonë, Shqipëria aplikon e pranohet në Këshillin e Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut. Më dhjetor 1992, Berisha viziton selinë e NATO-s, ku pritet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili në mars 1993 viziton vetë Shqipërinë", kujtoi një nga një hapat e hedhur Tritan Shehu. "Më 23 shkurt 1994, Berisha nënshkroi dokumentin Kuadër të Partneritetit për Paqe me NATO-s, duke e bërë Shqipërinë anëtaren e parë nga vendet ish-komuniste të saj. Më 20 prill, Kuvendi i Shqipërisë ratifikoi këtë dokument, me gjithë kundërshtitë e socialistëve në këto periudha", kujtoi deputeti demokrat. Sipas tij, "tani ne jemi anëtarë të NATO-s dhe si të tillë kemi përfitimet madhore, por edhe obligimet e mëdha ndaj kësaj aleance, obligime që lidhen me elementët financiarë, pjesëmarrjes, thellimin e demokracisë, luftës sonë ndaj krimit, drogës, trafiqeve, terrorizmit, racionalitetit në politikat rajonale dhe ato të jashtme etj., ndër të cilat fatkeqësisht jemi shumë larg asaj që kërkohet nga një vend anëtar në seriozitet, impenjim e rezultate. Pra, është më e dobishme që kjo qeveri të përpiqet të realizojë 'detyrat e shtëpisë' e të mos përdorë vendime të mundshme pozitive të NATO-s ndaj nesh e rajonit si 'fishekzjarrë' politikë për të kamufluar realitetin tonë të brendshëm", tha Shehu.

### Zv.ministri i Mbrojtjes: Investim me rëndësi politike e ushtarake

# Baza e NATO-s, Koçi: Dëshmon peshën e Shqipërisë për sigurinë në rajon

## *Ish-komandanti i bazës ajrore: U degradua në vitet '90*

Zëvendësministri i Mbrojtjes, Petro Koçi, e cilësoi ndërtimin e bazës ajrore në Kuçovë si një investim me rëndësi të madhe politike dhe ushtarake. Përmes një statusi në rrjetin social "Facebook", Koçi tha se kjo bazë dëshmon peshën dhe përparësinë që përfaqëson Shqipëria për sigurinë dhe paqen në rajon. Po ashtu, ai shtoi se nga ana tjetër rritet prezenca e NATO-s në rajonin tonë, në përgjigje të rolit jomiqësor ndaj interesave euroatlantike të vendeve të tilla si Rusia.

"Zhvillimi i bazës ajrore të Kuçovës nën kujdesin e NATO-s për t'u shndërruar në një bazë bashkëkohore për qëllime mbështetjeje logjistike për operacionet e furnizimit të forcave ajrore, për mbështetje të operacioneve të patrullimit ajror dhe natyrisht për qëllime stërvitore të Forcave Ajrore të Aleancës përbën një investim me rëndësi të madhe politike dhe ushtarake", u shpreh Koçi. "Kjo bazë, si e para e këtij lloji në Ballkanin Perëndimor dëshmon peshën dhe përparësinë që përfaqëson Shqipëria për sigurinë dhe paqen në rajon si edhe rritjen e prezencës së NATO-s në rajonin tonë, në përgjigje të rolit jomiqësor ndaj interesave euroatlantike të vendeve të tilla si Rusia. Ndërkohë, ky modernizim do të rrisë kapacitetet ushtarake të Forcës sonë Ajrore", theksoi zv.ministri i Mbrojtjes. "Natyrisht, ky është një lajm shumë i mirë dhe për interesat social-ekonomike të komunitetit të Kuçovës e më gjerë. Do të



Zëvendësministri i Mbrojtjes, Petro Koçi

**BAZA AJRORE**
"Zhvillimi i bazës ajrore të Kuçovës nën kujdesin e NATO-s për t'u shndërruar në një bazë bashkëkohore për qëllime mbështetjeje logjistike për operacionet e furnizimit të forcave ajrore, për mbështetje të operacioneve të patrullimit ajror dhe natyrisht për qëllime stërvitore të Forcave Ajrore të Aleancës përbën një investim me rëndësi të madhe politike dhe ushtarake"

këtë një investim me peshë të konsiderueshme financiare", shkruan Petro Koçi.

**BAZA AJRORE**

Baza ajrore e Kuçovës ka qenë e qetë këto ditë, edhe pse ka rritur shpresat e qytetarëve se bashkë me të do të ndryshojë edhe jeta e tyre. Qytetarët thonë në një reportazh të "Ora News" se për shumë vite janë lënë në harresë dhe kushtet ekonomike të tyre nuk janë fort të mira. Pranë Aviacionit të Kuçovës, që do administrohet nga NATO, gjithçka është e qetë dhe lajmi qarkullon edhe ndër radhët e punonjësve ushtarakë, por askush nuk ka folur. Ndërsa, ish-komandanti i Bazës Ajrore të Kuçovës, gjatë viteve 1998-2001, Epaminonda Tupa, piloti që ka fluturuar në këtë aerodrom për 35 vjet tregon se kjo bazë ka kryer shumë funksione si mbrojtjen e hapësirës ajrore, mbrojtjen e vendit dhe kualifikimin e pilotëve të rinj, që më pas kalonin në bazat e tjera. Ish-komandanti i Bazës Ajrore të Kuçovës shprehet se degradimi nisi në vitet '90, ku arsyeja kryesore ishte ajo e mungesës së buxhetit. Ai thotë se Kuçova zgjohej dhe flinte me zhurmat e avionëve dhe si shume të tjerë, shpreson se ky investim do të zgjojë po ashtu edhe ekonominë e këtij qyteti.



# Xhaçka: Pjesë e Forcave Speciale bëhen më të mirët

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhacka ka përshëndetur dje 13 fituesit e kursit gjashtëmujor të Forcave Speciale. Për t'u bërë pjesë e Forcave Speciale nuk është një garë e lehtë, pasi duhet të kalosh kursin intensiv të stërvitjes që zgjat 6 muaj si dhe konkurrencën, ku në 50 veta që kërkojnë ta kalojnë këtë kurs, zgjidhen vetëm 13 prej tyre. Rreth këtij kursi u shpreh edhe ministrja Xhaçka, e cila shkruan: "Kursin sfilitës 6-mujor e nisën 50 efektivë, por vetëm 13 e përfunduan. Respekte të gjithë pjesëmarrësve! Urime atyre që e përfunduan!", shkruan Xhaçka. Po ashtu, ministrja Xhaçka ka postuar edhe një video ku shihet demonstrimi i Forcave Speciale.

**MINISTRJA**
"Kursin sfilitës 6-mujor e nisën 50 efektivë, por vetëm 13 e përfunduan. Respekte të gjithë pjesëmarrësve! Urime atyre që e përfunduan!"

# Ish-kryeministri Berisha publikon dy denoncimet: E vërteta e bazës ajrore të Kuçovës

Ish-kryeministri Sali Berisha ka zbuluar sipas tij disa "të vërteta" rreth bazës ajrore të Kuçovës, e cila do të jetë tashmë edhe bazë e NATO-s për Ballkanin Perëndimor. Përmes një statusi në "Facebook", Berisha ka publikuar dy mesazhe nga oficerët dixhitalë, ku i pari thotë se shefi i Misionit CUBIK në atë kohe, në 2011, nënkolonel Lu Boros nuk pati marrëdhënie të mira me ministren Mimi Kodheli dhe u largua pa e përfunduar misionin e tij, për të cilin ishin bërë edhe shumë studime. "Grupi CUBIK mbronte idenë e zhvillimit të kësaj baze, si një bazë e rëndësishme e FA Shqiptare dhe të NATO-s (si një bazë Hostnation). Plani mbeti në sirtar rilindasish për më shumë se 7 vjet, ç'ka përbën një skandal politikisht dhe një humbje kohe të vlefshme në kuadër të modernizimit të FA me standardet e NATO-s", thuhet në denoncimin që i është dërguar Berishës nga një grup ushtarakësh në lirim dhe aktivë.



Gjykatësi zotëron një pasuri familjare me vlerë rreth 58.7 milionë lekë

# U konfirmua në detyrë, ONM rekomandon apelimin e vendimit të KPK-së për Zaganjorin

## *Ekspertët ndërkombëtarë, kundër kalimit të vetingut për kreun e Gjykatës së Lartë*

Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit u paraqiti Komisionerëve Publikë ditën e djeshme rekomandimin për të ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit vendimin e KPK-së për konfirmimin në detyrë të kreut të Gjykatës së Lartë, Xhezair Zaganjori. Vendimi për konfirmimin e gjykatësit në detyrë u mor më datë 24 korrik. Trupa gjykuese, e cila konfirmoi në detyrë Zaganjorin përbëhej nga Olsi Komici, Roland Ilia dhe Pamela Qirko. Gjatë seancës dëgjimore KPK vlerësoi se kreu i Gjykatës së Lartë pati bërë deklarime të pasakta të pasurisë dhe kontrata fiktive. Por ai u mbrojt duke thënë se kontratat ishin formale për pronën dhe brenda ligjit. Kryetari i Gjykatës së Lartë zotëron një pasuri familjare me vlerë rreth 58.7 milionë lekë, ndërkohë që të ardhurat ndër vite llogariten në 99.7 milionë lekë.

Më herët gjykatësi u shpreh se e mbështet reformën në drejtësi dhe se gjithçka e ka të dokumentuar. "Jam njeri i ligjit dhe erdha në proces. E kam mbështetur reformën në drejtësi, ndaj kam respektuar KPK dhe kam dokumentuar gjithçka. Kam 40 vite punë dhe kam punuar me përkushtim", tha ai.

**NJOFTIMI I INSTITUCIONIT TË KOMISIONERËVE PUBLIKË**

Në datë 24.07.2018, në përfundim të seancës dëgjimore përkatëse, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Xhezair Zaganjori, me detyrë kryetar i Gjykatës së Lartë. Sot, më datë 06.08.2018, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, u ka paraqitur Komisionerëve Publikë rekomandimin për ta ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për konfirmimin në detyrë të z. Xhezair Zaganjori. Komisionerët Publikë, pasi t'u jetë njoftuar vendimi me shkrim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit do ta shqyrtojnë atë krahas rekomandimit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Bazuar në pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka 30 ditë afat për t'ia njoftuar vendimin me shkrim Komisionerëve Publikë. Ky vendim ende nuk është njoftuar. Bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Komisionerët Publikë brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kanë të drejtë të paraqesin ankim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Institucioni i Komisionerëve Publikë është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Komisionerët Publikë përfaqësojnë interesin publik gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.



Kreu i Gjykatës së Lartë, Xhezair Zaganjori

**REKOMANDIMI**

Më datë 06.08.2018, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit u ka paraqitur Komisionerëve Publikë rekomandimin për ta ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për konfirmimin në detyrë të z. Xhezair Zaganjori.

**KALUAN VETINGUN, ASNJË KËRKESË PËR KLGJ**

Pavarësisht përfundimit të fazës së parë të vetingut, ende asnjë nga gjyqtarët e konfirmuar nuk ka aplikuar për në KLGJ. Janë bërë 7 ditë nga thirrjet për vendet bosh të kandidatëve për Këshillin e Lartë Gjyqësor, por akoma nuk është bërë asnjë kërkesë. Këshilli i Lartë Gjyqësor do ketë 11 anëtarë dhe përveç kontrollit në sistemin gjyqësor, do të vulosë vazhdimin e detyrës nga gjyqtarët e Krimeve të Rënda.

## Hetoi 'Gërdecin' dhe 'Bandën e Lushnjës', del i pastër në të tria shtyllat

# Vetingu, prokurori i Shkodrës, Arben Dollapaj rikonfirmohet në detyrë



**TIRANE** - Komisioni i Pavarur i Aplikimit ka rikonfirmuar në detyrë ditën e djeshme prokurorin e Apelit të Shkodrës, Arben Dollapajn. Prokurori, njëherësh kandidat për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, doli i pastër nga vetingu. Sipas Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nuk janë konstatuar problematika me pasuritë e tij. Prokurori mësoi se në të tria shtyllat e procesit të rivlerësimit: pasuria, figura morale dhe aftësitë profesionale rezultonte pa probleme. Dollapaj ishte i pranishëm vetëm në seancën e kaluar dëgjimore pa avokat. Trupa gjykuese drejtohej nga Lulzim Hamitaj, Olsi Komici relator dhe Brunilda Bekteshi. Sipas raportit të ILDKPKI-së, të çuar për KPK-në, prokurori Dollapaj ka pasuri të justifikuar dhe s'ka fshehje të saj. Nga hetimi i thelluar i KPK-së, Arben Dollapaj rezulton me pasuri të justifikuara. Sipas KPK-së, Dollapaj ka një apartament me sipërfaqe 76 metra katrorë në Bajram Curri, një shtëpi banimi 113 m2 në Selitë të Vogël, në kryeqytet, me vlerë 9 milionë lekë si dhe një shtëpi banimi në Valbonë të Tropojës, ku nuk kanë përfunduar ende punimet. Për shtëpinë në kryeqytet, të blerë në vitin 2011, si burim financiar janë kursimet personale, ndërkohë që ka marrë edhe një hua nga kunati prej 25 mijë dollarësh. Në përfundim të hetimit, KPK-ja thekson se nga deklarimet e provat e vëna nga subjekti gjithçka rezulton korrekte, përfshi një leje legalizimi për shtesë kati prej 123 metrash katrorë në shtëpinë e blerë në vitin 2011, pasi konfirmohen edhe nga Zyra e Legalizimit. Edhe raporti mbi pastërtinë e figurës, i ofruar nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar rezulton pozitiv për prokurorin e Apelit të Shkodrës. "Ka kryer me ndershmëri detyrën dhe me etikë të lartë profesionale, ka ruajtur të pastër figurën profesionale", rezulton sa i përket vlerësimit të aftësive profesionale të Dollapajt. Prokurori Arben Dollapaj ka pasur në shqyrtim disa nga çështjet më të rëndësishme si "Banda e Lushnjës", "Gërdeci" ku kërkoi rrëzimin e vendimeve të Shkallës së Parë dhe burgosjen e të pandehurve.

**HETIMI**

Sipas KPK-së, Dollapaj ka një apartament me sipërfaqe 76 metra katrorë në Bajram Curri, një shtëpi banimi me sipërfaqe 113 m$^2$ në Selitë të Vogël, në kryeqytet me vlerë 9 milionë lekë si dhe një shtëpi banimi në Valbonë të Tropojës, ku nuk kanë përfunduar ende punimet. Për shtëpinë në kryeqytet, të blerë në vitin 2011, si burim financiar janë kursimet personale, ndërkohë që ka marrë edhe një hua nga kunati prej 25 mijë dollarësh.



## Divorcet rriten frikshëm, rreth 8 mijë raste në 2017

Divorcet në vendin tonë kanë shënuar shifrën më të lartë të 5 viteve të fundit, ku në 2017 janë regjistruar plot 7956 zgjidhje martesash. Sipas statistikave nga Ministria e Drejtësisë, një vit më parë janë shënuar 311 divorce më shumë se në 2016-ën, ndërsa në krye të listës qëndron kryeqyteti me 1,897 raste divorcesh në 2017-ën, pasuar nga Vlora, Elbasani, Fieri, Shkodra dhe Korça. Ndërkohë, Puka dhe Tropoja kanë më pak zgjidhje martesash se qytetet e tjera, respektivisht vetëm 40 dhe 44 raste. Sipas psikologëve të gjykatave, shkaku më i madh që çon në prishjen e familjeve është emigracioni, me problemet e mëdha sociale që prodhon, kryesisht si pasojë e largimit të burrave. Në vendin e dytë është bixhozi. Kërkueset në këto raste janë gratë, të cila duan të mbrojnë fëmijët dhe pronën nga lënia në kumar prej burrave. Kërkesat për divorce si pasojë e përfshirjes së burrave në varësinë nga lojërat e fatit kanë ardhur duke u rritur, gjë që korrespondon edhe me shtrirjen e këtij fenomeni në çdo qytet të fshat të vendit. Arsyet e tjera të divorcit, sipas statistikave janë edhe varfëria, tradhtia bashkëshortore, dhuna e alkooli. Në vitin 2015 u vu re një trend uljeje i kërkesave për divorc, por në vitet pasardhëse ritmi ka qenë vetëm në rritje.


**NJOFTIM**

Ne date **08.08.2018** ne oren **16.00** ne zyren e permbaruesit gjyqesor privat **Irisa Tereziu PF** me adrese ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se paluajtshme te llojit **"Apartament"** me **sip.68 m2**, me nr.pasurie 2/166+1-5, ne zonen kadastrale 3682, me volum 2, faqe 54, i ndodhur ne Lagjia 11 Shtatori, pallati 9, shkalla 1, kati 2, apartamenti 5, Ure Vajgurore Berat.Cmimi ne ankand te trete eshte ne vleren **1,411,200 (nje milion e katerqind e njembedhjete mije e dyqind) lekë**.

**Njoftim për shitje me ankand**

**Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k** do të zhvillojë ankandin e parë për pasurinë e dorezanesin K S te ndodhura ne Panahore Mallakaster . Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga :
- Pasuria **"Are"** me nr. 206/48 vol. 5 fq 31, me siperfaqe **2500 m2** ZK 2869 me cmim **1.500.000** leke
- Pasuria **"Are"** nr.206/7 me vol 4, faqe 244, sipërfaqe **500 m2** ZK 2869, me cmim prej **100.000** lek
- Pasuria" me nr. 70/15, vol 6, faqe 85 me siperfaqe **51 m2** e ndodhur në zonën Kadastrale 2869 me çmimin në masën **520.832** lekë

Ankandi eshte progresiv e do të zhvillohet dt **16.08.2018** në orën **15:00** në Bulv "G.Fishta" Kulla 1,Kati 2, zyra.5. Kont tel. 672082543, e-mailit **ilir_dervishaj@yahoo.com,**
WEB www.powerjustice-al.com.

**STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON"
me PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOXHA**

**Dt. 08.08.2018 ora 16:00
Përfundon Ankandi i Parë për pasurinë:**
- **Pasuria "Truall+Ndërtesë" me sip.529.25 m2, me adresë Sallmone, Durrës. Me çmim 40 000 Euro**
- **Pasuria "Arë" me sip.3750 m2, me adresë Hardhishtë, Durrës. Me çmim 22 400 Euro**

**Ankandi Zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr: L.11, Blv.kryesor (ish kinma iliria) ,Kati-2, Durrës, Kontakt Cel 0682096575**

### Sherri banal, identifikohet autori e bashkëpunëtori

## I riu tenton të vrasë pronarin e dyqanit ushqimor ku punonte e dashura: Pse më përmend emrin



**VLORË** - Banorët e qytetit të Vlorës janë tronditur mbrëmë nga të shtënat me armë zjarri. Mësohet se ngjarja ka ndodhur rreth orës 22:20 pranë Universitetit "Ismail Qemali" në lagjen "Skelë" të këtij qyteti. Krismat e armëve në një prej zonave më të populluara të Vlorës ka shkaktuar panik tek banorët dhe pushuesit e shumtë. Forca të shumta policie kanë rrethuar zonën ku u regjistruan të shtënat dhe kanë nisur hetimet. Blutë kanë krijuar perimetrin e sigurisë, ndërsa në vendin e ngjarjes janë gjetur disa gëzhoja arme zjarri tip pistoletë. Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake dyshohet se ngjarja ka ndodhur pas një sherri banal. Sipas hetuesve të çështjes, pronari i një dyqani ushqimor u ka shpëtuar mrekullisht plumbave. Po të njëjtat burime sqaruan se një i ri ka shkuar në dyqanin ushqimor ku punonte e dashura dhe është konfliktuar me pronarin. "Pse më ke lakuar emrin mua", mësohet se i ka thënë i riu pronarit të dyqanit dhe më pas ka nxjerrë armën. Edhe pse pronari i ka thënë se nuk e ka përmendur dhe nuk ka punë me të, autori ka shtënë në drejtim të tij tri herë. Fatmirësisht asnjë prej tyre nuk e ka kapur pronarin e dyqanit. Autori ka qenë i shoqëruar nga një tjetër person, që e ka nxjerrë pronarin jashtë objektit. Ndërkaq, policia ka shoqëruar vajzën dhe pronarin për të marrë dëshmitë e tyre. Dy autorët e ngjarjes janë identifikuar, ndërsa blutë janë vënë në kërkim të tyre.

### Të afërmit e viktimës: Çifti po grindej, kur hymë në banesë Meritën e gjetëm pa jetë

# Durrës, gjendet e vdekur në banesë bashkëshortja e efektivit të policisë

## *Hetuesit: Dyshohet se nëna e 2 fëmijëve u vetëvra me plumb në kokë me armën e shërbimit të të shoqit*

**DURRËS**

Bashkëshortja e një efektivi policie në Durrës është gjetur e vdekur në banesën e saj. Ngjarja ku humbi jetën Merita Hajdari ka ndodhur pasditen e djeshme në lagjen nr.7 të qytetit bregdetar. Pas kryerjes së veprimeve paraprake hetimore, burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së këtij qarku bënë me dije se dyshohet që 47-vjeçarja të jetë vetëvrarë me armë zjarri. Ndërkohë që blutë nuk përjashtojnë as pistën e vrasjes. Sipas hetuesve të çështjes, nëna e dy djemve të rritur (njëri prej tyre i martuar) ka humbur jetën nga një plumb në kokë. Nga ana tjetër, të afërm të familjes Hajdari (me origjinë nga Ishmi) thanë se çifti po grindej dhe se kur kanë hyrë në banesë, Meritën e kanë gjetur të vdekur.

**NGJARJA**

Burime për "Gazeta Shqiptare" pohuan se rreth orës 13:20 të ditës së djeshme, në sallën operative, ngjarja u njoftua si një krim brenda familjes. Menjëherë drejt vilës trekatëshe ku banonte e ndjera u nis grupi hetimor, në përbërje të të cilit janë një inspektor i krimeve të rënda si edhe prokurori i gatshëm, i cili do të kryejë ekspertizën e vendit të ngjarjes duke ndërtuar ngjarjen sipas dëshmive. Ndërkaq, në komisariatin e Durrësit janë marrë në pyetje familjarët e 47-vjeçares si edhe bashkëshorti, Sherif Hajdari, punonjës policie në portin e Durrësit. "Më datë 06.08.2018, rreth orës 13:20, në lagjen nr.7, Durrës është gjetur e vrarë në banesë me armë zjarri shtetasja M.H. 47 vjeçe. Nga hetimet paraprake dyshohet se është vetëvrarë. Grupi hetimor po punon për sqarimin e rrethanave të ngjarjes", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Mësohet se në vilën trekatëshe banonin dy familje, polici bashkë me të vëllanë, për të cilët fqinjët thanë se kishin marrëdhënie shumë të mira mes tyre. Në momentin e ngjarjes, në banesën e efektivit të policisë ka pasur edhe persona të tjerë.

**HETIMET**

Pas ngjarjes së rëndë, janë zbardhur detaje të reja në lidhje me rrethanat në të cilat humbi jetën Merita Hajdari. Sipas burimeve nga grupi hetimor, të afërmit e viktimës kanë deklaruar se çifti Sherif dhe Merita Hajdari kanë debatuar me njëri-tjetrin për disa minuta. Gjatë marrjes në pyetje, ata dëshmuan se kishin dëgjuar nga jashtë banese sherrin mes çiftit ndërsa janë shprehur se kur hynë në banesë, panë gruan të vrarë me armë zjarri. "Dëgjuam që çifti po zihej dhe po bërtisnin, por nuk ishim brenda në shtëpi në atë moment. Kur hymë brenda në banesë, Merita ishte pa shenja jeta. Por nuk pamë se çfarë ndodhi", mësohet të jenë shprehur të afërmit e 47-vjeçares. Menjëherë pas ngjarjes, efektivi i policisë, Sherif Hajdari u thirr në komisariat, ku u mor në pyetje për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes. Nisur nga këqyrja e vendit të ngjarjes, por edhe dëshmive të dhëna, policia dyshon se nëna e dy fëmijëve është vetëvrarë me armën e shërbimit të të shoqit me një plumb në kokë. Do të jetë aktekspertiza që do të hedhë dritë mbi këtë ngjarjeje.





Banesa e familjes Hajdari ku ndodhi ngjarja

**DËSHMIA**

Sipas burimeve nga grupi hetimor, të afërmit e viktimës kanë deklaruar se çifti Sherif dhe Merita Hajdari kanë debatuar me njëri-tjetrin për disa minuta. Gjatë marrjes në pyetje, ata dëshmuan se kishin dëgjuar nga jashtë banese sherrin mes çiftit, ndërsa janë shprehur se kur hynë në banesë, panë gruan të vrarë me armë zjarri.

## Vidhnin energjinë elektrike, procedohen 5 subjekte private në Durrës dhe Shkodër

Pesë raste të vjedhjes në mënyrë flagrante të energjisë elektrike nga subjekte private, biznese kryesisht (hoteleri, restorant, bar kafe, etj.) janë zbuluar gjatë kontrolleve të fundit të OSHEE-së në Durrës dhe në Shkodër. Referuar kontratave sipas OSHEE, abonentët e gjetur me shkelje janë: Arian F.; Kudret G.; Martin H.; Sherife B. dhe Sanije H.. Dy prej tyre janë shpallur në kërkim në çastin e konstatimit të vjedhjes së energjisë elektrike, në prani të oficerëve të Policisë së Shtetit dhe të Hetimit. Mësohet se forma e vjedhjes ishte manipulimi i matësit, furnizim me energji elektrike pa pasur kontratë me OSHEE, si dhe rilidhje të paligjshme të energjisë pas ndërprerjes si debitorë. Sakaq, rastet me dokumentacionin përkatës u janë përcjellë organeve kompetente për procedim të mëtejshëm.



**SHKURT**

### Sekuestrohen 53 kg marijuanë, bien në pranga 2 shqiptarë

**GREQI** - Policia greke ka sekuestruar 53 kg marijuanë, ndërsa ka arrestuar dy shqiptarë gjatë një operacioni në Artë. Mësohet se policia ka ndjekur një automjet të dyshuar që vinte nga kufiri. Operacioni u finalizua në Kompoti, ku u ndalua një mjet dhe u arrestuan një vajzë 21-vjeçare dhe shoferi 33 vjeç. Brenda mjetit, me ndihmën e qenit të policisë, në vende të improvizuara enkas u gjetën dhe sekuestruan 52 pako me 53 kg 620 gr marijuanë. Pakot ishin të lidhura me litarë që ndihmonin në nxjerrjen e tyre jashtë mjetit.

### Përplas në rrugë fëmijën 5-vjeçar, kapet shoferi

**LUSHNJE** - Një aksident i rëndë automobilistik ka ndodhur mëngjesin e djeshëm në Lushnjë. Teksa drejtonte automjetin tip "Ford", shtetasi me inicialet L.B., 58 vjeç, banues në Lushnjë, ka përplasur një fëmijë të mitur. Mësohet se ngjarja ka ndodhur në fshatin Gorre të këtij rrethi. Fatmirësisht fëmija 5-vjeçar ka pësuar dëmtime në trup, por është jashtë rrezikut për jetën. Ai është dërguar në Spitalin e Traumës në Tiranë, ku ndodhet nën kujdesin e mjekëve. Ndërkaq, blutë arrestuan në flagrancë drejtuesin e automjetit. Materialet në ngarkim të 58-vjeçarit i kaluan për hetime të mëtejshme Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë.

### Agjencia e Pronave publikon regjistrin për 12 qarqet: Ja kujt i është njohur e drejta

# Pronat, kompensimi për vitet 2001-2013, përfitojnë 3700 persona

## Emrat/ Lista e re e ATP: Shuma e parave që merr secili

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka publikuar dje regjistrin e vendimeve për individët që u është njohur e drejta për kompensimin e pronave për vitet 2001-2013. Janë në total 3700 pronarë, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit dhe vlerësimi financiar për çdo pronë. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka publikuar edhe regjistrin e përditësuar të vendimeve, të cilat kanë njohur të drejtën për kompensim dhe të vlerësimeve për vitet për 12 vitet e fundit. Pronarët që kanë një vendim mund të përfitojnë edhe nga pagesat e përshpejtuara. Ata duhet të paraqiten në ATP dhe plotësojnë formularin-tip, të zgjedhin një nga tre afatet që parashikon ligji, pagesë brenda vitit, brenda 3 vjetëve ose brenda 5 vjetëve. "Gazeta Shqiptare" publikon formularët që mund të plotësohen për të përfituar nga përparësitë që jep ligji i ri për të marrë kompensimin me procedurë të përshpejtuar, apo për të marrë pjesë në ankande.

**TRI AFATET**

Janë vendosur tri afate pagesash të përshpejtuara. Pagesë brenda një viti, brenda tri vitesh dhe brenda pesë vjetësh. Për secilin variant në një VKM të posaçëm është përcaktuar edhe përqindja e pagesës. Për pagesën brenda një viti, pronari merr 20% të vlerës së faturës, për pagesën brenda tri viteve merr 30% dhe brenda pesë viteve merr 40% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere. Të gjitha subjektet që kanë një vendim përfundimtar kompensimi, pavarësisht rendit kronologjik të tij dhe llojit të zërit kadastral të pronës së vlerësuar, kanë të drejtë të aplikojnë pranë ATP-së me kërkesë të veçantë, ku shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht. Kërkesat e veçanta për kompensim financiar do të trajtohen sipas kësaj procedure: nga çdo fond vjetor buxhetor i kompensimit financiar, jo më shumë se 1/3 e tij mund të përdoret për kërkesat e veçanta të kompensimit financiar, të gjitha subjektet kërkuese që shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht me kërkesë të veçantë duhet të aplikojnë pranë ATP-së brenda vitit të çeljes së fondit vjetor buxhetor të kompensimit financiar. Pas aplikimit për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, ATP-ja përgatit vlerësimin financiar të pronës, pavarësisht rendit kronologjik të vendimit dhe në rastin e disa aplikimeve për kompensim me kërkesë të veçantë do të zbatohet rendi kronologjik i datës së vendimeve për këto aplikime.

## KOMPENSIMI PËR VITET 2001-2013

| Nr. Rendor | Nr/ Dosje | Qarku | Emri (*Subjekti*) | | Mbiemri (*Subj* | VLERESIMI |
|---|---|---|---|---|---|---|

1 274 Lezhë Sefer Seferi
2 490 Fier Maksim Cuko 6,234,607
3 393 Fier Zabit Zoto 5,343,996
4 549 Fier Bajram Kembora 982,072
5 501 Fier VASILLAQ LLUPO 620,256
6 175 Fier VELI MANKO 418,289
7 285 Fier GURI SEFA 360,339
8 176 Durrës Xhemal Veseli 6,912,162
9 12 Berat Tajar Shëmilli
10 108 Lezhë Zef Kola 516,880
11 36 Fier Ali Metani, Asqeri Velaj, Burbuqe Murataj, Eqerem Murataj, Esma Murataj (Osmenau), Gezim Metali, Kujtim Met 4,525,388
12 88 Fier Qemal Hodaj 2,088,978
13 75 Fier Bedri Zeneli
14 41 Fier Xhevdet Celaj 260,000
15 272 Lezhë Kol Mark Prendi 3,004,202
16 448 Berat Hysen Helmesi
17 448 Berat Hysen Helmesi 464,217
18 486 Berat Zeqir Pollogati 262,151
19 486 Berat Zeqir Pollogati
20 36 Berat Nazmi Hazisllari 893,169
21 442 Berat Skender Veizaj 9,145,822
22 370 Berat Shefqet Ago
23 42Q Shkodër Lazer Pal Fushaj 1,421,337
24 100 Lezhë Kurt ; Elez Pojani 11,756,273
25 202 Berat PETRIT MUHAMETI
26 93 Shkodër Rexhep Reci 67,000
27 42 Berat Myslim Hasan Xhaferri, Sadik Abaz Xhaferri 1,045,366
28 155 Vlorë Nexhmi Ballko 2,385,011
29 284 Vlorë BesHir Sinani
30 101 Lezhë Musa Brahim Bushati 4,180,000
31 69 Lezhë Jak Mati Pjetri 1,857,803
32 837 Fier Tomor Rrapaj 269,442
33 845 Fier Lipi Konomi 817,307
34 1427 Fier Faslli Xhepa 3,323,717
35 1504 Fier Shefit Zyko 6,586,061
36 591 Fier Vasil Naqe 10,806,420
37 527 Fier Llaqi Stefani 1,360,083
38 907 Fier Pajtim Cobani 8,143,136
39 873 Fier Jashar Hoxha 3,172,500
40 1306 Fier Qazim Mesini 1,100,222
41 173 Fier 2,794,114
42 81 Fier Skënder Gjeli 1,676,528
43 566 Fier Fatbardha Vokopola 329,797
44 609 Fier Llazi Sota 6,756,408
45 840 Fier Zhaneta Mone
46 836 Fier Gëzim Kaloshi
47 1137 Fier Kito Dhanili
48 298 Fier Gëzim Velmishi 8,464,071
49 102 Lezhë Emin Lohja 1,047,830
50 456 Shkodër Trashegimtaret e tij 292,195
51 387 Shkodër Lin Ndrek Lukaj 5,023,926
52 378 Berat Ramadan Lala 550,018
53 16 Berat Bedri Shmilli
54 34 Berat Agim Lavdari 5,311,001
55 34 Berat Agim Lavdari 153,582
56 27 Berat Qani Koroni
57 42 Berat Idriz Shmilli 2,310,384
58 42 Berat Idriz Shmilli 6,586,360
59 38 Berat Isa Shmilli 3,832,064
60 113 Lezhë Kol Gjok Makaj 796,351
61 74 Fier Thoma Kusta
62 41 Fier Ahmet Haxhiaj, Eduart Haxhiaj, Hekuran Hodaj, Luftije Zeninaj (Hodaj), Nazif Haxhiaj, Rexhep Haxhiaj, Safete 611,398
63 96 Vlorë Astrit Kallapodhi 49,800
64 96 Vlorë Astrit Kallapodhi 1,845,543
65 156 Kukës Shaqir Bilal Morina 102,268
66 145 Kukës Ali Vocrri Muca 1,012,638
67 171 Kukës Musa Halil Gojani 8,015,568
68 36 Berat Selajdin Xhaferi 294,365
69 36 Berat Selajdin Xhaferi
70 40 Berat Kamber Xhaferri
71 40 Berat Kamber Xhaferri 4,790,080
72 35 Berat Bektash Sherri
73 28 Berat ZAIM SHERRI 422,350
74 28 Berat ZAIM SHERRI
75 30 Berat Xhevdet Lavdari 223,974
76 30 Berat Xhevdet Lavdari
77 3 Berat Hasan Lavdari 5,340,939
78 44 Berat Idajet Hada 5,125,386
79 177 Durrës Gëzim Shehu 2,415,248
80 848 Fier Todi Shkurti -9,242,131
81 1458 Fier -107,531,130
82 9+179 Fier Zija Vrioni
83 273 Lezhë Mark Ndoci 3,007,850
84 37 Durrës Seit Dollma 5,766,300
85 156 Durrës Hamid Kallari 462,071
86 245 Kukës Ismail Zenel Zhupi 138,552
87 29 Berat Hamit Sherri 827,016
88 17 Berat Rufedije Spaho 4,848,290
89 17 Berat Rufedije Spaho 543,686
90 20 Berat Hajri Kalluci
91 20 Berat Hajri Kalluci 2,254,383
92 41 Berat Bajame Gorezi
93 15 Berat HAXHIRE SPAHO
94 25 Berat Dilaver Zaimi 472,216
95 25 Berat Dilaver Zaimi
96 33 Berat Minushe Lulaj
97 146 Durrës Riza Kamberi
98 20 Shkodër Dode Pepaj 522,445
99 2085 Tiranë HASAN BRAHJA
100 244+244/1 Lezhë Dede Daci
101 411 Tiranë Besnik Shirja, Haxhire Shirja, Reshat Shirja 3,569,650
102 27 Kukës Bajram Rrustem Gjongeci
103 471 Vlorë Andromaqi Loli 685,149
104 531 Berat Njazi Saliasi
105 46 Berat SHEFQET METHOXHA 578,427
106 8 Berat Selman Lulaj
107 6 Berat ALI SPAHO 4,896,056
108 6 Berat ALI SPAHO 1,770,171
109 532 Berat Bajram Radeshi 713,361
110 30 Berat Hajri Kadiu
111 403 Shkodër Fahri Cen Smajli 1,391,943
112 36 Shkodër Vebi Hasani 1,148,633
113 127 Lezhë Zek Leci(Marlekaj) 16,398,545
114 3102/1 Tiranë SABRIJE CAPI
115 2678 Tiranë KLEANTHI DERVISHI 22,632,957
116 118 Fier ZALO HOXHA 133,218
117 113 Fier Stavri Naco 36,400,000
118 492 Fier Hydajet Leka 2,797,578
119 524 Fier Shaqir Xhepexhiu 621,684
120 469 Fier Kujtim Gina 2,889,350
121 119 Fier KADRI RABIA 6,216,840
122 528 Fier Ramadan Alico 1,769,727
123 28 Fier ENVER HASANLLIU 3,641,292
124 205 Fier Eqerem Dalla 1,586,635
125 518 Fier RAZIE TURKU 819,853
126 120 Fier Bahrie Taullau 12,740,000
127 519 Fier ENVER LICI 1,085,205
128 203 Fier ATHINA PUKA 571,357
129 521 Fier Isan Toro 8,454,902
130 227 Fier Aqif Xhepexhiu 2,486,736
131 199 Fier Esat Manoku 4,038,578
132 275 Fier Andrea Sylari 6,811,880
133 534 Fier Mustafa Murrizi 1,670,258
134 505 Fier Seit Kurti 6,736,686
135 537 Fier Mihallaq Lako 4,550,000
136 499 Berat Adil mUsai 0
137 536 Fier Abedin Toshkollari 6,862,207
138 439 Fier Vait Arapi 469,519
139 553 Fier Nazmi Licka 1,986,428
140 474 Fier Celik Spahiu 361,169
141 218 Fier Qemal Lufta 548,562
142 545 Fier Qemal Dervishi 361,169
143 476 Fier Vesel Topulli 577,870
144 558 Fier Hasan Sefa 722,338
145 62 Fier Adem Kurti 5,486,213
146 522 Shkodër Asim Man Hysa 562,086
147 92 Lezhë Manuel Nik Shabi 1,561,350
148 178 Lezhë Pal Gjin Kolziu 5,710,080
149 106 Lezhë Manuel Nik Shabi
150 162 Lezhë Prek Ivanaj 2,081,800
151 144 Lezhë Martin Gjeka 3,305,898
152 53 Shkodër Nazim Grenazi
153 52 Shkodër Xhemalije Puka 2,200,140
154 105 Lezhë Gjovalin Nikaj 12,970,650
155 59 Lezhë Lek Turkaj
156 248 Lezhë Vitore Pjetrushi
157 236 Lezhë Ded Marku 2,891,135
158 54 Shkodër Pal Dodaj -2,504,940
159 24 Lezhë Ismail Bajram Hasani 2,107,000
160 217 Lezhë Gjek Tahiri 16,257,612
161 426 Berat Luftar Bega
162 365 Berat MALIQ BAZE
163 365 Berat MALIQ BAZE 2,050,681
164 18 Berat Petref Jashar Shmilli
165 536 Berat Ali Hoxha 902,097
166 536 Berat Ali Hoxha
167 353 Berat Selim Kelliçi 1,685,600
168 170 Berat Qemal Zaimi 4,607,505
169 201 Berat Murat Dine Hajdari 6,573,840
170 3 Berat Hamdi Izet Kulli 2,662,947
171 535 Berat Dervish Qama 150,012
172 23 Berat Baftjar Zylali 3,130,400
173 525 Shkodër Engjell Ceka 644,140
174 753 Korçë Andrea Jakova 1,406,423
175 1596 Korçë Arefi Xhone -50,733
176 758 Korçë Hamza Hysenlliu 118,850
177 364 Korçë Irena Haxhi 126,420
178 55 Shkodër Mhill Majnishta 0
179 893 Korçë Bashkim Lipo 120,000
180 281 Durrës Ymer Dervishi -1,428,125
181 1870 Durrës 33,249,468
182 134 Lezhë Vat Ivanaj 613,709
183 56 Berat Stavri Sholla 290,073
184 38 Berat AGUR DURAKU 333,858
185 127 Berat Lili Buçka 3,141,822
186 2 Berat Sami Arif Haderi 1,057,217
187 506 Berat Ramadan Qazim Sinani
188 506 Berat Ramadan Qazim Sinani 1,613,190
189 15 Berat Muke Tusha
190 15 Berat Muke Tusha 463,064
191 411 Berat Qani Zaimi
192 293 Berat Selman Koprencka 3,067,661
193 797 Korçë Edmond Selenica 186,737
194 824 Korçë Pandi Qiriako 191,558
195 259 Korçë Bukuri Jakupi 191,558
196 17 Berat Jaho Brisku 3,173,430
197 83 Berat Vasil Jorgji Tavani 3,881,326
198 141 Berat Alim Bega 759,846
199 85 Berat Raku Buçka 3,078,608
200 427 Berat Hysen Hito 954,368
201 215 Berat Hyda Nazmi Kalluçi 3,986,231
202 215 Berat Hyda Nazmi Kalluçi
203 438 Berat Engjell Shahu
204 4 Berat Rushan Leshi 6,810,944
205 46 Berat Fatmir Bilçari 2,819,244
206 5 Berat Tefik Shyqyri Molishti 186,085
207 6 Berat NAFIE DURRO 1,012,520
208 1713 Korçë Theologji Menkshi 0
209 165 Durrës Hysen Kasmi 4,589,292
210 789 Fier Nexhip Duce 244,682
211 186 Durrës Gani Dija 284,199
212 189 Durrës Hysen Kertusha 3,932,236
213 178 Durrës 308,559
214 197 Durrës Ali Guza 505,243

106 38 Berat Burhan Lamce
107 15 Berat Xhemal Mustafai 1,468,685
108 534 Berat Isa Lamce
109 43 Berat Mustafa Lamce
110 18 Berat Muharrem Ali Mustafaj 734,342
111 52 Berat SHAHIN LAMCE 1,240,371
112 45 Berat Xhevahir Tahir Mustafaj 1,071,932
113 28/1 Berat Xhite Çeta
114 34 Berat Maliq Lamçe
115 319 Berat Agim Lamce
116 54 Berat Ismail Pire 542,968
117 42 Berat Myslim Hasan Xhaferri, Sadik Abaz Xhaferri
118 306 Tiranë RESHAT KARAJ 515,200
119 20 Kukës Ahmet Halil Selimaj 208,527
120 61 Elbasan 3,751,571
121 266 Lezhë Pashk Gjini
122 897 Korçë Faik Meka -2,220,323
123 215 Korçë PRANVERA ROTA 3,039,832
124 281 Korçë Ilia Llogori 91,347
125 380 Korçë DHIMITRAQ BALLAURI 1,166,256
126 1121 Korçë Hysen Dervishi 1,512,379
127 (224) 87 Korçë Vanthulla Kondakci 0
128 526 Korçë Arjani Grazhdani 4,656,627
129 52 Gjirokastër Stavro Proko 177,625
130 511 Fier Sokrat Sema 5,007,126
131 166 Fier Vesel Ahmeti 319,887
132 147 Fier Mystehak Xhanaj 1,926,584
133 3 Fier Rrapi Shkoza 1,639,027
134 1497 Shkodër Ferid Ali Ulqinaku 297,885
135 305 Durrës 4,827,200
136 673 Fier Flamur Bregasi 2,991,447
137 1071 Fier Nasibi Skënderi 4,436,153
138 458 Fier Kasem Çukaj 3,884,965
139 1518 Fier Thoma Combashi 6,062,072
140 1141 Fier Riza Agaci 5,217,545
141 957 Fier Gëzim Sulejmani 2,078,668
142 91 Fier Lumturi Hajdari 4,288,440
143 530 Fier Votim Lici
144 743 Fier Resat Xhindole 5,573,038
145 563 Tiranë HYSEN HASA
146 765 Korçë Kico Angjeli 4,329,725
147 132 Korçë MUHARREM SHKEMBI 749,736
148 1105 Korçë Mihal Çapi 209,307
149 769 Korçë Irena Pano 1,465,109
150 784 Korçë Sokol Turani
151 136 Elbasan ISON DELIU -6,236,204
152 541 Fier Maj Qëndro 2,039,393
153 1457 Fier Luan Meta 3,427,671
154 148 Fier Grigor Ndoni 5,857,104
155 1 Fier Sokrat Mehilli 5,916,500
156 372 Fier Kadri Xhafa
157 1336 Fier Aleksandër Vesho 5,081,544
158 140/B Fier Hava Likaj 1,441,367
159 227 Lezhë Ndue Lazer Fusha 962,161
160 530 Vlorë Elham Zahaj 426,100
161 168 Vlorë Jaup Ferati 637,276
162 29 Berat QERAMEDIN STERMASI 4,268,497
163 20 Berat Jonuz Lamçe
164 35 Berat Gani Lamçe 1,269,331
165 32 Berat Xhaferr Gerxhani 456,373
166 494 Berat Xhelo Ajasllari
167 494 Berat Xhelo Ajasllari 721,993
168 356 Berat Malip Lamçe 251,629
169 240 Berat Iliaz Osman Zhuka 659,768
170 36 Berat Ferit Çerenishti 756,296
171 187 Lezhë Gjek Koec Mekshi 2,775,898
172 33 Berat Selam Hamza Zotkaj 1,068,374
173 33 Berat Selam Hamza Zotkaj 444,288
174 1 Berat Rustem Shyqyri Gorica 3,554,304
175 30 Berat Safete Mehmet Selimaj 202,954
176 102 Berat Petraq Dhaskali 6,690,880
177 22 Kukës Shahip Ahmet Kecit 193,905
178 21 Kukës Shaban Dan Leka 156,176
179 54 Gjirokastër Ismail Karafili
180 3114/1 Tiranë SKENDER SPAHIU -192,075,570
181 3170 Tiranë SABRI HEKA 4,118,594
182 183 Elbasan NDRICIM HYSA 2,544,009
183 1226 Fier Pandi Thoma 2,610,780
184 531 Fier Skënder Cani 5,387,490
185 560 Fier Ramazan Pema 5,466,686
186 546 Fier Koli Permeti 678,180
187 559 Fier Shyqeri Toska 4,950,311
188 307 Fier Riza Shefa 1,741,247
189 23 Kukës Rrahim Xhafer Rexhamti 136,901
190 791 Durrës Asllan Doku 3,361,720
191 247 Lezhë Hamdi Mlika 2,246,983
192 708 Korçë Skënder Satka 350,179
193 857 Fier Javer Mustafa 1,085,361
194 28 Fier
195 262 Fier Flora Muslihaku 2,223,360
196 713 Fier Jorgji Rista 416,091
197 484 Fier Hysen Metushi 984,393
198 228 Fier Skënder Cani 4,446,720
199 526 Fier Islam Çako 1,627,500
200 410 Fier Nazmi Karajani 1,344,382
201 225 Fier Asllan Ruco
202 345 Fier Hasan Shameti
203 344 Fier Ismail Mukaj 2,634,504
204 357/1 Gjirokastër Hysen Qose
205 961 Korçë Sotiraq Kostandini 87,545
206 164 Korçë GURI GRAPSHI 291,816
207 875 Korçë Koco Glozheni 525,269
208 25 Kukës Din Ram Dullaj 595,305
209 26 Kukës Beqir Riza Shehu 529,160
210 680 Elbasan XHEVAIR QAFA
211 207 Lezhë Kol Ndue Ujka 3,385,066
212 894 Korçë Gezim Dule 46,656
213 427 Korçë MARJANA FURXHI 160,392
214 798 Korçë Llazo Xhelo 327,242
215 818 Korçë Aimir Qosja 135,444
216 458 Korçë Ilir Sovjani 525,269
217 393 Korçë JORGAQ BALLAURI 155,079
218 1714 Korçë Llazar Leka
219 99 Korçë Pirro Naço 4,762,914
220 26 Shkodër Gjon Gjek Sinishta 237,622
221 16 Shkodër Shaban Osja 475,243
222 55 Shkodër Fadil Hasani 285,146
223 10 Shkodër Brahim Nurja 116,726
224 692 Gjirokastër Eflatun Mera
225 19 Lezhë Hasim Hamzi 1,167,264
226 365 Tiranë KUKLI -10,388,535
227 432 Tiranë Banush Misiri, Haxhire Misiri, Nafije Misiri, Nazmi Misiri, Veli Misiri
228 358 Korçë THOMA PEPIVANI 93,760
229 907 Korçë Mihallaq Mano 1,020,364
230 241 Korçë Anastasi Xhumetiku 1,295,400
231 80 Shkodër Mark Gjoni 380,195
232 1124 Korçë Hamdie Xhabej 58,363
233 117 Berat Aqif Shkurti 1,432,853
234 404 Berat Njazi Kuçuku 493,377
235 404 Berat Njazi Kuçuku 1,889,856
236 401 Berat Rakip Ibrahim Gorezi 444,672
237 483 Berat Zenel Flamuri 256,163
238 483 Berat Zenel Flamuri
239 440 Berat Shyqyri Dushi 1,131,510
240 471 Berat Rustem Zenel Guri
241 471 Berat Rustem Zenel Guri 686,246
242 41 Berat 879,825
243 396 Berat Baftjar Turhani 3,675,214
244 396 Berat Baftjar Turhani 156,643
245 121 Berat Muharrem Mustafaj 1,238,134
246 121 Berat Muharrem Mustafaj
247 368 Berat 300,154
248 379 Berat SKENDER MERKAJ 776,647
249 379 Berat SKENDER MERKAJ
250 454 Berat Xhorxhi Omeri
251 454 Berat Xhorxhi Omeri 312,243
252 484 Berat Ethem Çoro
253 349 Berat Ali Yzeiri 511,484
254 419 Berat Novruz Naska 488,688
255 45 Berat Shaban Llango 350,805
256 45 Berat Shaban Llango 1,467,418
257 37 Berat Xhaferr Bregu 2,691,433
258 1 Berat Agim Zenel Taka 4,128,085
259 40 Berat Dhimitraq Kozma Kreku 1,853,448
260 188 Fier
261 242 Fier Ismet Luzati 3,112,704
262 498 Fier Pilo Xhaho 1,378,205
263 67 Fier Loni Sema 3,078,231
264 168 Lezhë Lek Ndreu 2,660,538
265 248 Lezhë Pjeter Lulaj 2,016,695
266 100 Shkodër Remzi Nikshiqi 119,701
267 101 Shkodër Xhelal Bekteshi 474,566
268 102 Shkodër Selim Ndue Kol Vuji 417,576
269 278 Fier Aqif Bengaj 3,855,882
270 110 Fier Hiqmet Zaloshnja 7,123,016
271 315 Fier Leko Prifti 7,411,993
272 109 Fier Medi Zaloshnja 7,123,016
273 977 Fier Sabaudin Hoxha 1,224,127
274 146 Fier Fecor Rama 751,284
275 96 Fier Pjetri Mone 953,878
276 416 Fier Petraq Shanko 431,064
277 593 Korçë Eliona Rota 618,631
278 683 Korçë Ropi Marko 2,982,264
279 974 Korçë Rexhep Saliko Caushi 88,981
280 102 Shkodër Aishe Muho 1,097,977
281 433 Shkodër Bashkesia Islamike (Xhamija Shiroke) -21,196,134
282 541 Korçë Vangjush Daco 355,925
283 3014 Tiranë SAIRE BIÇAKU -16,474,374
284 203 Lezhë Bashkim Muslia 4,310,792
285 227 Lezhë Pashko Pjetri 15,253,920
286 307 Elbasan MAHMUT SULA
287 559 Korçë Ivoni Balli 1,720,274
288 1126 Korçë Astrit Licollari 784,306
289 1127 Korçë Adriatik Tahirllari 227,679
290 257 Lezhë Kol Zef Prendashi 15,253,920
291 14 Shkodër Vehbi Mati 2,007,006
292 18 Shkodër Daut Shabani 1,344,605
293 81 Korçë Tahir Agolli
294 41 Elbasan EFGJENI PAPAJANI 902,524
295 365 Elbasan FADIL LEKA 888,556
296 91 Elbasan FATMIR KULLA 2,836,281
297 28 Kukës Rexhep Ali Gjuni 363,966
298 43 Lezhë Nafije Todri(Metani) 1,542,341
299 1289 Fier Pandi Shkurti 1,048,001
300 1357 Fier Mina Leçka 2,929,318
301 515 Fier Veli Begaj 1,816,177
302 1102 Fier Hoxhi Koçia 2,486,580
303 1394 Fier Agim Zaloshnja 9,097,692
304 141 Elbasan SHYQYRIJE HOXHOLLI
305 186 Lezhë Nikolin Nikolli
306 3 Tiranë TEQJA 3,190,300
307 150 Lezhë Mirash Murri 1,025,402
308 38 Kukës Selim Sokol Hajdari 197,736
309 599 Fier Aleksandër Vesho 4,641,711
310 158 Tiranë FATBARDH HARIZI 3,915,100
311 24 Berat Manushaqe Vavla 827,101
312 447 Berat
313 447 Berat 179,866
314 57 Berat Tefik Petref Mustafaj
315 26 Berat Ilmi Methoxha 2,612,234
316 26 Berat Ilmi Methoxha
317 495 Berat Mehmet Ahmetaj 225,984
318 495 Berat Mehmet Ahmetaj 328,369
319 473 Berat Zylyftar Gjoni 410,698
320 11 Berat Qerim Lulaj 200,493
321 11 Berat Qerim Lulaj
322 372 Berat PERPARIM KADIU 1,911,198
323 372 Berat PERPARIM KADIU
324 443 Berat Ferat Çipi
325 40 Berat Servet Hysko
326 40 Berat Servet Hysko 1,007,235
327 490 Berat Haki Musabelliu 424,709
328 490 Berat Haki Musabelliu
329 12 Shkodër Muhamet Ulqini 1,159,298
330 119 Shkodër Hamid Muriqi 1,137,773
331 576 Tiranë MEREPEZA
332 49 Berat Toli Gori Vangjeli 346,231
333 36 Kukës Drita Ali Duki 129,754
334 502 Berat Manushaqe Hysenaj 4,569,396
335 502 Berat Manushaqe Hysenaj 426,042
336 54 Berat Haki Avdyl Veleshnja 5,212,095
337 279 Durrës Mirushe Gobja (Sheqerja)
338 600 Fier Lejla Toptani
339 801 Fier Lejla Toptani 6,064,974
340 5 Fier Lejla Toptani 9,402,860
341 5 Fier Nikollaq Prifti 1,763,938
342 120 Fier Hekuran Sulaj 451,582
343 99 Shkodër Xheladin Persekuj 817,723
344 527 Shkodër Ilir Golemi 823,001
345 788 Fier Arjan Mema 2,064,672
346 777 Fier Myrto Bako 6,076,158
347 68 Fier Kadri Hoxha 3,211,712
348 197/A Gjirokastër Eli c ami
349 899 Korçë Karafil Larti 3,552,462
350 1063 Korçë ZIJA LEPI 1,100,576
351 1094 Korçë Feta Koçibelli 51,000
352 545 Korçë Shefqet Pojani 1,520,545
353 1268 Korçë Mirdash Terolli 736,710
354 2 Shkodër Trashigimtare 831,891
355 308 Durrës Zyra Duraku 908,000
356 708 Korçë Kostaq Marko
357 708 Korçë Kostaq Marko 120,499
358 1879 Durrës 1,755,000
359 170 Lezhë Pjeter Kola 9,111,225
360 29 Kukës Abedin Sadik Istrefaj 249,349
361 8 Kukës Ahmet Zeqir Hasaj 582,765
362 9 Kukës Selim Nel Hasaj 742,708
363 649 Korçë Dhanai Jorgji 193,907
364 12 Durrës Nazim Tafa 3,894,800
365 1128 Korçë Vait Kabashi 783,078
366 370 Korçë Remzi Xhinaku 2,367,849
367 585 Gjirokastër Afroviti Vasilia 1,204,392
368 167 Gjirokastër Zigur Sinani 135,494
369 96 Shkodër Fifat Hyka 1,913,138
370 120 Shkodër Bernand Shkoza 1,264,612
371 3085 Tiranë HYSEN BALLA -32,613,337
372 19 Berat FILE HAZENDARI 10,323,360
373 113 Berat Safet Sulovari 8,327,510
374 15 Berat Nebi Polovina 5,221,447
375 15 Berat Nebi Polovina -1,462,728
376 115 Berat
377 18 Berat Myrvete Vavla 5,462,345
378 18 Berat Myrvete Vavla 5,138,739
379 62 Berat Barjam Myrtezai 1,397,718
380 429 Berat Mustafa Brami
381 101/1 Berat Qemal Dushi 1,810,776
382 371 Berat Ervehe Kovaçaj 150,234
383 385 Berat Muharrem Bregu 207,419
384 363 Berat Veli Petriti
385 363 Berat Veli Petriti 942,652
386 431 Berat Merjeme Shasho
387 487 Berat Fiqiret Qemali 259,374
388 55 Berat Teki Halilaj 747,139
389 374 Berat Abedin Hysko
390 374 Berat Abedin Hysko 265,956
391 33 Tiranë Abdulla Bishqemi 594,042
392 61 Berat Muharrem Asim Lybeshari
393 667 Elbasan HAXHI MILOT MALOKU 158,980
394 1307 Tiranë FERIDE FRASHERI 73,665,900
395 1524 Fier Arqile Shushka 353,195
396 1523 Fier Miti Cuko 1,750,383
397 491 Fier Dilaver Begaj
398 131 Shkodër Emine Barbullushi 2,204,037
399 137 Shkodër Ruzhdi Barbullushi 936,415
400 501 Shkodër Ejll Gjoni 778,697
401 306 Durrës Jorgji Shapka
402 104 Durrës Fatmir Ramadani 12,307,000
403 307 Durrës Aneta Cumashi 2,278,400
404 1993 Durrës Ali Xhezairi
405 122 Vlorë Razip Rama 1,446,000
406 1705 Vlorë Eqerem Hasanaj 992,075
407 374 Tiranë Haxhi Kashari 585,760
408 750 Korçë Dhori Bibolli 196,092
409 941 Korçë Agim Hyseni 1,287,194
410 303 Durrës Islam Kodra 1,786,500
411 319 Durrës Sabri Hoxha 3,796,800
412 660 Durrës Violeta Sava 3,042,660
413 727 Durrës Adem Rranja
414 167 Lezhë Ded Ndoka 12,581,358
415 832 Korçë Kristaq Rembeci 242,424
416 440 Korçë LEONIDHA PELTEKU 224,685
417 440 Korçë LEONIDHA PELTEKU 181,931
418 290 Korçë Dervish Jacellari 285,333
419 373/p Shkodër Injac Kabashi 1,350,000
420 569 Korçë Lluka Bardhi 452,100
421 312 Durrës Petrit Kuqi 4,684,600
422 249 Lezhë Hajdar Neziri 964,319
423 233 Lezhë Ali Brahimi 3,540,540
424 155 Lezhë Ahmet Dushkaj 909,910
425 614 Korçë Dituri Jace 223,805
426 619 Korçë Ruzhdi Goskova 324,947
427 619 Korçë Ruzhdi Goskova 70,953
428 619 Korçë Ruzhdi Goskova 113,768
429 1600 Korçë Thomaq Papargjir
430 31 Kukës Nexhip Hallaqi 584,647
431 33 Tiranë Abdulla Bishqemi 1,525,765
432 920 Fier Llazar Stefi 7,243,036
433 575 Fier Nikolla Rista 5,740,946
434 574 Fier Dhimitër Rista 3,759,916
435 576 Fier Vangjel Rista 3,032,190
436 654 Fier Vangjel Furari 3,069,691
437 174 Shkodër Kol Kiri 561,388
438 90 Fier Saimir Mernica
439 1122 Korçë Adem Barci 606,377
440 1608 Korçë Vanthulla Kondakci 970,000
441 542 Gjirokastër Kristaq Toli 3,221,399
442 542 Gjirokastër Kristaq Toli 2,215,520
443 160 Shkodër Gjyljana Bushati 146,195
444 212 Shkodër Faik Rrustemi 303,219
445 150 Shkodër Muhamet Selman Bisha 323,434
446 223 Shkodër Prel Melaca 140,925
447 68 Shkodër Fran Boka -21,935,726
448 32 Kukës Gani Asllan Jonuzi 319,391
449 229 Lezhë Gjon Toma
450 62 Korçë Donika Margo 74,072
451 83 Korçë Hamdie Memo 161,737
452 1770 Korçë Gaqi Muli
453 496 Durrës Hysen Hoxha
454 33 Kukës Xhemal Krasniqi 154,601
455 1211 Vlorë Begë Begaj 1,297,798
456 1285 Vlorë Eqerem Dervishi 1,279,980
457 239 Vlorë Kadrie Brahimi 633,439
458 34 Kukës Tahir Ibish Braha 479,005
459 76 Berat Hekuran Terpollari 612,141
460 59 Berat Avdyl Hajro Metaj 581,112
461 59 Berat Avdyl Hajro Metaj
462 74 Berat Tomorr Salillari 1,095,032
463 34 Berat Mustafa Hysko
464 475 Berat Sinan Alushani 2,148,090
465 475 Berat Sinan Alushani
466 28 Berat Rakip Arra
467 474 Berat Gëzim Gjoni 376,208
468 474 Berat Gëzim Gjoni 532,149
469 474 Berat Gëzim Gjoni 428,838
470 474 Berat Gëzim Gjoni 95,514
471 474 Berat Gëzim Gjoni 504,860
472 467 Berat Arben Shekmbi
473 421 Berat Tahir Këlliçi
474 424 Berat Haki Lamçe 3,139,313
475 73 Berat Brahim Ali Jaho 1,229,048
476 65 Berat Syrja Dollani 3,056,123
477 23 Berat Tomorr Salillari 4,862,131
478 66 Berat Irfan Refat Molishti 0
479 1802 Tiranë NEXHAT STURÇE

**(vijon)**

Voltiza Duro

### Përfitojnë edhe personat me diploma të integruara. Si bëhet aplikimi për punë

# Vendimi: Kush mund ta ushtrojë profesionin e mësuesit, kriteret

## "Llojet e diplomave që duhet të zotërojnë kandidatët"




LIGJ
Nr. 48/2018
PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 69/2012, "PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR
KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:
Neni 1

Faksimilie e vendimit të Këshillit të Ministrave

**PUNËSIMI**
Pranimi dhe emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor, ndërsa emërimi i tyre bëhet nga drejtori i institucionit arsimor, sipas renditjes në portalin "Mësues për Shqipërinë".

Të gjithë ata persona që kanë një diplomë universitare të ciklit të parë ose të dytë, apo edhe një diplomë universitare të ngjashme me fushën e mësimdhënies mund të ushtrojnë profesionin e mësuesit. Ky është vendimi më i fundit i marrë nga Këshilli i Ministrave, në të cilin përcaktohet lloji i diplomës që duhet të zotërojë individi për të punuar si mësues i parashkollorit, arsimit fillor, arsimin e mesëm të ulët si dhe për arsimin e mesëm të lartë. "Mësuesi për arsimin parashkollor duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë bachelor, që formon mësues të arsimit parashkollor. Mësuesi për arsimin fillor duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë bachelor dhe diplomë të ciklit të dytë master Profesional, që formon mësues të arsimit fillor, ose diplomë për arsimin fillor të ish-institucioneve të larta pedagogjike", - theksohet në Fletoren Zyrtare. Ndërkohë, në këtë të fundit bëhet me dije se mësuesi për arsimin e mesëm të ulët dhe për arsimin e mesëm të lartë duhet të disponojë diplomën e ciklit të parë bachelor në fushën e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë dhe diplomën e ciklit të dytë master me 120 ECTS në fushën e mësuesisë, që lidhet me programin e studimit të ciklit të parë.

**DIPLOMAT E INTEGRUARA**

Gjithashtu, Këshilli i Ministrave ka vendosur se profesioni i mësuesit mund të ushtrohet edhe nga individë që zotërojnë diplomë universitare të ciklit të parë dhe të dytë ose diplomë universitare të integruar, të ngjashme ose të përafërt me fushën e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe njohuri të certifikuara në formimin psiko-pedagogjik nga institucione të arsimit të lartë, që ofrojnë programe të studimeve të formimit të vazhduar. Diplomat e njëvlershme, diplomat e ngjashme ose të përafërta me diplomat e sipërpërmendura të këtij neni në fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psikopedagogjike përcaktohen me udhëzim të ministrit. "Mësuesi i arsimit fillor, i arsimit të mesëm të ulët dhe i arsimit të mesëm të lartë, mësuesi i shkollave të arsimit të orientuar, mësuesi i kulturës së përgjithshme në shkollat profesionale, mësuesi që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe mësuesi me diplomë të ngjashme ose të përafërt me diplomat në fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar ushtron profesionin pasi: a) të ketë kryer me sukses praktikën profesionale; b) të ketë kaluar me sukses provimin e shtetit në fushën e formimit të tij, siç parashikohet në ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009, 'Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij'", - nënvizohet në vendimin e Këshillit të Ministrave. Në këtë të fundit thuhet gjithashtu se pranimi dhe emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor, ndërsa emërimi i tyre bëhet nga drejtori i institucionit arsimor, sipas renditjes në portalin "Mësues për Shqipërinë".

bashkëpunimi gjerman
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT
Implemented by giz

**ANNOUNCEMENT**

**Private Vocational Training Providers – Call for (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals**

The GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED), implemented on behalf of the German Federal Ministry of Economic Cooperation and Development, under the component of Technical Vocational Education & Training (VET), will cooperate with private vocational training providers in the country with the aim to scale-up VET interventions, complementary to the courses offered by public VET providers.

In this respect, the programme is conducting a Call for (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals from **23 July – 20 August 2018**, which shall help to identify private training providers that offer Vocational Training (VT) in line with the requirements below:

- Under each contract, the private training providers, will offer several training courses. The training duration of each course per batch should be at least 1 month.
- The training courses under each contract should target altogether 50-150 young people (19-34 years) in total. 40% of the participants are to be female and 30% are to be returning migrants from EU Member States.
- The courses should reflect the following prioritized sectors: ICT, tourism, agro-processing, textile & footwear and innovative/creative crafts; but are not necessarily limited to these sectors, if justified based on local labour market needs and employment prospects.
- The courses should be demand-driven and include work-based learning based on local labour market needs and eventually aim at employment.
- The proposals should reflect and include information on job placement mechanisms to guarantee employment of minimum 50% of the participants.
- There is no limitation in terms of geographical location, though priority will be given to (rural) locations where public/private vocational training is non-existent or very limited.
- The overall implementation timeframe for the interventions is up to 9 months.

The proposals that are to be selected through this call shall receive financial support ranging between 30,000 – 50,000 EURO (equivalent in ALL). The number of contracts is flexible until the overall programme budget of EUR 400,000 assigned for this activity is allocated.

**Selection Procedure:**

**First step**: All (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals received by applicants will be evaluated based on the eligibility and technical criteria described in the evaluation grid.

**Second Step**: The potentially qualified candidates will be invited for interviews and required to submit a budget proposal.

**Third Step**: Contracts will be awarded to the companies with best technical and financial offer.

Please, send an email to giz-albanien@giz.de, to receive the Proposals format and the Evaluation Grid.

For further questions contact us via email to giz-albanien@giz.de during the period 23 July – 20 August 2018.

bashkëpunimi gjerman
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT
Implemented by giz
MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

**Press Notice**

**To the attention of the general public**

**Make it in Albania – OPENING OF THE SECOND CALL FOR PROPOSALS**

Following its mandate from the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ) and in partnership with the Ministry of Economy and Finance (MoEF), the GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED) under its third component of Social Participation of Marginalized Youth and Minorities is **opening its Second Call for Proposals from 23 July – 21 August 2018.**

The aim of this call for proposals is to financially support local civil society organizations, to implement small-scale projects that strengthen social empowerment and cohesion, and enable the target group to engage actively, in line with their interests and capabilities, to find common solutions to improve their-, and their respective communities' social and economic situations.

All CSOs registered in Albania with at least 2 years of relevant experience and proven record in youth empowerment and social cohesion are invited to submit proposals under this call for proposals.

The 10 envisaged proposals to be selected through this competitive call shall receive financial support in the amount between 10,000 – 20,000 EUROs (equivalent in ALL).

The proposed interventions submitted by the local CSOs may take different shapes and may include activities that strengthen the interaction between different groups of youth, activities that contribute to the development of life skills, cultural and sports activities, as well as activities that foster the inclusion of minorities, women, persons with disabilities and migration returnees. The long-term outcome of these activities should aim at increasing the target group's social capital and future employability prospects.

In order to submit a proposal for participation in this call, it is necessary to consult the Application Guidelines that may be obtained by it through the ProSEED Facebook page. The Application Guidelines state the defined objectives, and requirements to be complied with and provide detailed information on the procedures for selection. Interested local CSOs can find all the official templates for submitting proposals under this call annexed to these guidelines. Applying CSOs shall submit their applications only electronically to makeitinalbania@giz.de. All applications must be submitted in English language.

For further questions and clarifications on the Application Guidelines, please contact us via email to: makeitinalbania@giz.de during the period **16 – 20 of July 2018**, prior to the opening of the call. After this period GIZ ProSEED shall not answer any enquiry related to the call.

**The deadline for the submission of the proposals is 21 August 2018, 16:00h.**

## Veliaj: Do investojmë në çdo lagje të Tiranës

# Nisin punimet për rehabilitimin e një blloku banimi në Laprakë



Bashkia e Tiranës po vazhdon punën intensive për rehabilitimin e zonave periferike, për të krijuar ambiente sa më të këndshme për qytetarët. Ditën e djeshme kanë nisur punimet për ndërtimin e një lulishteje të re në rrugën "Pandi Dardha" në Laprakë, e cila do të transformojë tërësisht bllokun e banimit, që më parë ka qenë i mbushur me inerte apo i zaptuar nga parkingjet private. Sipas projektit, do të ndërtohet një shesh rekreativ për të gjitha moshat, ku hapësira do t'u dedikohen jo vetëm këndeve për fëmijë, por edhe grupmoshave më të rritura, të cilët do të kenë mundësi që të qëndrojnë pranë gjelbërimit. Ndërhyrja në këtë bllok pallatesh parashikon edhe ndërtimin e trotuareve, sistemimin e parkingjeve mes pallateve, ndriçimin e tyre dhe vendosjen e të gjithë sinjalistikës së nevojshme, duke rritur sigurinë. Kryebashkiaku Erion Veliaj ka shprehur vendosmërinë që çdo lagje e kryeqytetit të ketë një kënd lojërash dhe hapësira çlodhëse për më të rriturit. Ndërkaq, dy ditë më parë vetë Veliaj ishte i pranishëm në Kashar ku inspektoi nga afër punimet e Bulevardit të Ri, që do të lidhet me një rrjet rrugësh, të cilat kanë nisur të ndërtohen nga Bashkia e Tiranës. Kryebashkiaku siguroi se urbanizimi do të prekë edhe ato zona, të cilat si pasojë e keqadministrimit nga ish-komunat kanë mungesa në infrastrukturë. Më tej Veliaj nënvizoi se investimet e reja do të rrisin edhe vlerën e pronës së qytetarëve dhe të bizneseve, si dhe u shpreh se bashkia po shfrytëzon periudhën e verës për të ecur me shpejtësi në projektet e nisura për përmirësimin e infrastrukturës së qytetit.

Fituesit e raundit të parë shpallen brenda 28 gushtit. Mundësitë për jofituesit

# Zbardhen datat për aplikimet dhe regjistrimet në universitete

## *Kur mund të çregjistroheni nga një program studimi*

Voltiza Duro

Të gjithë maturantët që kanë aplikuar në një prej programeve të studimit në universitete, tashmë mund të njihen me procedurën e datat për aplikimin dhe regjistrimin në universitete në të tria raundet. "Gazeta Shqiptare" publikon sot kalendarin e plotë me datat e aplikimeve, datat e afishimit të listave të renditjes së kandidatëve, afatet e regjistrimit pranë sekretarive mësimore si dhe datat e çregjistrimit. Kështu, aplikimin në portalin "u-Albania" në raundin e parë maturantët patën mundësi ta kryenin nga 30 korriku deri në 4 gusht të këtij viti. Të gjitha të dhënat e plotësimit të formularit A2 u kanë kaluar universiteteve, të cilat do bëjnë renditjen e kandidatëve sipas pikëve të grumbulluara. Ndërkohë, brenda 28 gushtit 2018 do të afishohen dhe publikohen listat me renditjen e aplikantëve, ndërsa regjistrimi i fituesve në raundin e parë do të bëhet nga 30 gushti deri në 12 shtator. Por kandidatët për universitete kanë të drejtë që në 13 shtator të çregjistrohen nga programi i studimit ku janë regjistruar dhe të riaplikojnë në raundin e dytë.

**RAUNDI I DYTË**

Riaplikimet në portalin "u-Albania" mund të kryhen sërish nga maturantët në afatin kohor 15-20 shtator 2018, çka do të shënojë edhe hapjen e raundit të dytë. Ndërkohë, afishimi dhe publikimi i listave të renditjes së aplikantëve në këtë raund do të bëhet brenda 25 shtatorit 2018 e më tej në datat 27 shtator-6 tetor fituesit mund të regjistrohen pranë sekretarive mësimore. Edhe në raundin e dytë, maturantët kanë mundësi që të çregjistrohen sërish nga programi i studimit ku u shpallën fitues për të riaplikuar sërish në raundin e tretë.

**RAUNDI I TRETË**

Të gjithë ata kandidatë që kanë aplikuar në një prej degëve të studimit në universitete në raundin e dytë, por ende nuk janë regjistruar kanë mundësi të regjistrohen pranë sekretarive mësimore në datat 9-13 tetor të këtij viti. Sakaq, aplikantët që nuk janë shpallur fitues as në raundin e parë, as në raundin e dytë, mund të riaplikojnë sërish në afatin kohor 15-18 tetor 2018. Ndërkohë, regjistrimi i kandidatëve të miratuar në sekretaritë mësimore do të bëhet në 19 dhe 20 tetor për t'i dhënë fund kështu procesit të aplikimit dhe regjistrimit në universitete për vitin e ri akademik 2018-2019. Çdo raund do të përbëhet nga 7 faza 48-orëshe secila.



**28**

**GUSHT FITUESIT, RAUNDI I**

Ndërkohë, brenda 28 gushtit 2018 do të afishohen dhe publikohen listat me renditjen e aplikantëve, ndërsa regjistrimi i fituesve në raundin e parë do të bëhet nga 30 gushti deri në 12 shtator.

**25**

**SHTATOR FITUESIT, RAUNDI II**

Publikimi i listave të renditjes së aplikantëve në këtë raund do të bëhet brenda 25 shtatorit 2018, e më tej në datat 27 shtator - 6 tetor fituesit mund të regjistrohen pranë sekretarive mësimore.

### KALENDARI PËR MATURANTËT

| Datat | Raundi i parë |
|---|---|
| 30 korrik-4 gusht 2018 | Aplikimi i maturantëve në portalin "u-Albania" |
| Brenda 28 gushtit 2018 | Afishimi dhe publikimi i listave të renditjes së aplikantëve |
| 30 gusht-12 shtator 2018 | Regjistrimi i aplikantëve të shpallur fitues në sekretaritë mësimore |
| 13 shtator 2018 | Çregjistrimi nga programi i studimit |
| **Datat** | **Raundi i dytë** |
| 15-20 shtator 2018 | Aplikimi i maturantëve në portalin "u-Albania" |
| Brenda 25 shtatorit 2018 | Afishimi dhe publikimi i listave të renditjes së aplikantëve |
| 27 shtator-06 tetor 2018 | Regjistrimi i aplikantëve të shpallur fitues në sekretaritë mësimore |
| 07 tetor 2018 | çregjistrimi nga programi i studimit |
| **Datat** | **Raundi i tretë** |
| 09-13 tetor 2018 | Regjistrim i kandidatëve në programet e studimit në të cilat kanë aplikuar në raundin e dytë dhe nuk janë regjistruar në asnjë program studimi |
| 15-18 tetor 2018 | Aplikim për maturantët që nuk janë shpallur fitues as në raundin e parë, as në Raundin e dytë |
| 19-20 tetor 2018 | Regjistrim i kandidatëve të miratuar në sekretaritë mësimore |

**FAZAT 48-ORËSHE**

Ndërkohë, regjistrimi i kandidatëve të miratuar në sekretaritë mësimore do të bëhet në 19 dhe 20 tetor për t'i dhënë fund kështu procesit të aplikimit dhe regjistrimit në universitete për vitin e ri akademik 2018-2019. Çdo raund do të përbëhet nga 7 faza 48-orëshe secila.



## Klosi: Duhet të shtojmë turizmin alternativ

Komiteti Rajonal i Turizmit për qarkun e Vlorës u mbajt këtë herë në Finiq të Sarandës. "Vende si Finiqi dhe zona të tjera turistike duhet të promovohen dhe zhvillohen shumë më shumë, në mbështetje të qëndrimit se pasi kemi mundur të sigurojmë turizmin e verës, të detit dhe të rërës, duhet të kemi fokusin më fort edhe te turizmi alternativ", -deklaroi ministri Klosi. Më tej, ky i fundit bëri me dije se po punohet për të krijuar një rrjet më të mirë agroturistik, duke shfrytëzuar lehtësitë fiskale të miratuara në parlament për ngritjen e strukturave agroturistike.

## AKU asgjëson 122.5 kg mish, masa ndaj 12 subjekteve

Ditën e djeshme, gjatë kontrolleve nga AKU janë asgjësuar plot 122.5 kg mish derri në Lezhë si dhe janë ndërmarrë 12 masa administrative për subjektet që punonin jashtë kushteve të tregtimit në Elbasan. Inspektorët e terrenit DRAKU-Lezhë konstatuan pesë subjekte me shkelje të kërkesave ligjore, pasi ata kryenin aktivitetin e tregtimit të mishit në një ambient të pamiratuar dhe pa kushte higjienosanitare. Pas bllokimit, sasia e sipërpërmendur e mishit u asgjësua në Landfillin e Shkodrës, ndërsa subjektet u gjobitën me 100 mijë lekë gjobë secila.

## Veseli: S'do ketë ndarje, do hyjmë në OKB me kufijtë e pavarësisë

# Thaçi: Propozimi për zgjidhje paqësore me Serbinë është i qartë

## Nishani: Kosova është 'Jerusalemi' i shqiptarëve

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, edhe një herë vazhdon të këmbëngulë në qëndrimin e tij në raport me bisedimet me Serbinë dhe idesë së propozuar prej tij. Përmes një postimi në rrjetin social "Twitter", ai thotë se propozimi i tij për një zgjidhje paqësore me Serbinë tashmë është i qartë. "Propozimi im për një marrëveshje paqësore me Serbinë është i qartë. Nuk ka ndarje përgjatë vijave etnike, por në korrigjimin e kufirit dhe njohje reciproke", shkruan Thaçi. Ndonëse Thaçi deri vonë ishte kundër idesë për korrigjimin e kufirit me Serbinë, por tani në çdo postim të tij në rrjete sociale e madje edhe në konferenca e mbështet këtë deklaratë të tij. Ideja e tij u kundërshtua nga opozita dhe madje edhe nga partnerët e koalicionit. Ndërsa sot në një shkrim ekskluziv për "Koha Ditore", kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli ka dalë kundër idesë së presidentit Thaçi. "Në asnjë rrethanë, ndarja e Kosovës nuk do të jetë temë e dialogut", thotë Veseli ndër të tjera. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh lider i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, u ka dhënë përgjigje debateve e shkrimeve të ndryshme në media sa i përket dialogut Kosovë-Serbi dhe mundësisë së ndarjes së Kosovës. Veseli ka thënë se situata e krijuar ka ardhur si pasojë e mungesës së veprimit institucional, që prodhon konsensus e vendimmarrje shtetërore. Si rezultat, sipas Veselit, ky debat e ka humbur krejtësisht seriozitetin për të përfunduar në një qarkullim të lirë pa doganë të teorive të konspiracionit dhe tërheqje vijash të reja në hartën politike të Kosovës e rajonit, sipas preferencave subjektive. "Por, vendimet e shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës janë të qarta. Në asnjë rrethanë, ndarja e Kosovës nuk do të jetë temë e dialogut. Kosova do të shkojë në dialog, në mënyrë që finalja e tij të prodhojë një marrëveshje ndërkombëtarisht obligative, e cila sjell njohjen e Kosovës, ulësen në OKB dhe përshpejtimin e rrugës së integrimeve euroatlantike. Kjo është axhendë e jona e përbashkët, me SHBA-të dhe BE-të. Nuk do të ketë ndarje të Kosovës, as nuk do të diskutohet kjo çështje", ka thënë Veseli në një shkrim të botuar në "Koha Ditore". Sipas kreut të Kuvendit, ndarja e Kosovës është një nga pretendimet e vjetra të Serbisë, të cilat kanë marrë fund një herë e përgjithmonë në vitin 1999. "Kosova nuk ka asgjë për të dhënë. Kosova është shtet i pavarur e sovran dhe integriteti territorial i saj është i pacenueshëm. Debatit mes liderëve nga Shqipëria dhe Presidenti Hashim Thaçi për lëvizjen e kufijve të Kosovës me Serbinë i është bashkëngjitur edhe ish-Presidenti i Shqipërisë, Bujar Nishani. Ai e quan Kosovën "Jerusalem" të shqiptarëve, duke arsyetuar kështu interesimin e secilit shqiptar për çështjet e Kosovës. Nishani e ka quajtur Kosovën 'Jerusalemin' e shqiptarëve, prandaj sipas tij, çdo situatë në Kosovë nuk i takon vetëm këtij shteti, por të gjithë shqiptarëve kudo. Kosova nuk është çështje thjesht e një shteti, por kolona kryesore e sigurisë kombëtare për shqiptarët. Në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Luginë apo kudo qofshin ata, anekënd botës. Jo rastësisht, ndër shekuj kryengritjet për liri të shqiptarëve kanë nisur nga Kosova. Ndaj, Kosova është 'Jerusalemi' i shqiptarëve.





**Nishani**

**DEKLARATA**

"Kosova nuk është çështje thjesht e një shteti, por kolona kryesore e sigurisë kombëtare për shqiptarët. Në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Luginë apo kudo qofshin ata anekënd botës. Jo rastësisht, ndër shekuj kryengritjet për liri të shqiptarëve kanë nisur nga Kosova. Ndaj, Kosova është 'Jerusalemi' i shqiptarëve".

### Rohan: Hapi përfundimtar, njohja e sovranitetit të Kosovës

## Ish-zëvendësi i Ahtisarit: Do hapet 'kutia e Pandorës'. Jo ndarje e shkëmbim territoresh

Albert Rohan, ish-numri dy në negociatat për statusin përfundimtar të Kosovës i konsideron të tejkaluara dhe të rrezikshme idetë për ndarje ose shkëmbim të territoreve mes Kosovës dhe Serbisë. Në një bisedë për "Koha Ditore", diplomati austriak ka thënë se Kosova tashmë ka bërë kompromiset e saj, duke pranuar pakon e Marti Ahtisaarit, mbi bazën e së cilës Kosova shpalli pavarësinë më 17 shkurt të vitit 2008. "Me pranimin e të drejtave të gjera për minoritetet, në veçanti për komunitetin serb dhe Kishën Ortodokse Serbe, siç përfshihet në Planin e Ahtisaarit, si dhe decentralizimin e kompetencave administrative, Kosova tashmë ka bërë kom-



promiset e saj", ka thënë ish-zëvendësi i Ahtisaarit. Por, sipas tij, reciprociteti ka munguar nga ana e Serbisë, për të cilën thotë se vazhdon të ketë qëndrim armiqësor ndaj Kosovës. "Si hap i parë, Serbia duhet të ndalë agjitacionin e vet armiqësor kundër Kosovës, duke bllokuar lirinë e lëvizjes dhe pranimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare, si dhe pjesëmarrjen në forume rajonale. Hapi përfundimtar duhet të jetë njohja e sovranitetit të Kosovës nga Serbia", ka theksuar Rohan. Muajve të fundit brenda debatit të dialogut ka zëra që avokojnë ndarjen ose shkëmbimin e territoreve të Kosovës si një zgjidhje përfundimtare. Ndërkaq, zyrtarët më të lartë serbë, përfshirë edhe ministrin e Jashtëm Ivica Daçiç, vazhdojnë të pohojnë publikisht se, "kjo është e vetmja zgjidhje realiste". "Unë kam kundërshtuar vazhdimisht idenë e ndarjes ose shkëmbimit të territoreve. Këto janë koncepte të vjetruara të shekujve të mëparshëm, të cilat nuk duhet të kenë vend në kohët moderne.

### Ivica Daçiç: Ende është e hapur mundësia për dialog

## Rriten spekulimet për kufijtë kosovarë, avionët serbë ngrihen mbi Luginën e Preshevës

Serbia nis stërvitjet ajrore në jug të vendit, ndërkohë që Ministria serbe e Mbrojtjes njoftoi fillimin të hënën të një stërvitjeje që do të zgjasë për 4 ditë, ndërsa nga ana tjetër, kryefjalë qëndrojnë spekulimet për bashkimin e Luginës së Preshevës me Kosovën. Manovrat ajrore përfshijnë Nishin dhe rajonet e tjera jugore, përfshirë edhe Preshevën, Medvegjën dhe Bujanovcin, të populluara nga shqiptarë etnikë. Manovrat, sipas Ministrisë serbe të Mbrojtjes, janë planifikuar kohë më parë. Megjithatë, njoftimi është publikuar në një moment kur autoritetet serbe, ato kosovare dhe ndërkombëtare i druhen një përshkallëzimi të tensioneve në veri të Kosovës, për shkak të skadimit të afatit për krijimin e Shoqatës së Komunave Serbe. Frika nga përshkallëzimi i tensioneve detyroi forcat e KFOR-it të shtojnë praninë në veri të Kosovës. Prej 4 gushtit, forcat e NATO-s morën kontrollin pranë liqenit të Gazivodës në kufirin Kosovë-Serbi. Prani të shtuar të tyre ka edhe në veri të Mitrovicës. Zyrtarisht, përfaqësuesit e KFOR thanë se bëhet fjalë për vetëm për një stërvitje të planifikuar kohë më parë. Ndërkohë që për ministrin e Jashtëm serb, Ivica Daçiç çdo propozim lidhur me dialogun me Kosovën është një mundësi e



mirë. Ai thotë se duhen të bëhen përpjekje për marrëveshje kompromisi, që do të ishte në interes të të gjitha palëve. Daçiç, megjithatë ka deklaruar se shqiptarët janë problemi kryesor për arritjen e kompromisit, pasi duan jo vetëm njohjen e Kosovës, por edhe bashkimin e luginës së Preshevës. Ai ka folur për ndryshim të pozicionit të SHBA-ve dhe Rusisë në lidhje me Kosovën. Ai ka theksuar se ardhja e ndihmësekretarit amerikan të Shtetit, Wess Mitchel, ka qenë vendimtare për ndryshimin e qëndrimit të administratës amerikane.

### Kërcënohet Ramush Haradinaj, policia shton masat e sigurisë

Disa ditë më parë, kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj ka marrë një kërcënim nga persona të panjohur. Kërcënimi në adresë të kryeministrit ka bërë që autoritetet të shtojnë masat e sigurisë ndaj Haradinajt. Burimet e "Indeksonline" brenda policisë kanë thënë se ka disa ditë që është shtuar numri i mbrojtjes së afërt të kryeministrit dhe kështu do të jetë deri në një vendim tjetër kur të bjerë shkalla e rrezikshmërisë. Ndonëse nuk kanë treguar se për çfarë kërcënimi bëhet fjalë, sipas burimeve të "Indeksonline", kërcënimi është duke u trajtuar seriozisht.

A DONI TË ZGJATENI EDHE PAK MË SHUMË? ZBULONI SE SI

SUMMER pages
SUPLEMENT I GAZETA SHQIPTARE
E martë 7 Gusht 2018



## Tuna rikthehet me klip, lë pa fjalë me linjat



## Vajza e ish-deputetes 'ndez' rrjetin

BULEVARDI POLITIK



- Adrenalina në maksimum, Presidenti Meta e nis ditën me sport ekstrem
- Manjani: Si është puna, Ramës i pëlqen pushteti ekstrem
- Voltana "humor" shkodran, gjen "armikun" e fesë për posterat
- Arushi ngjan me presidentin, Kina ndalon "Winnie The Pooh"



Rrëfehet basketbollisti: Si e përjetova fitoren e Superkupës

# BRUNO ZYKA:

# Ja sa paguhem në Shqipëri, e shoh veten jashtë

"Duartrokitjet e familjes kanë peshën e gjithë botës"

### Rrëfehet basketbollisti: Si e përjetova fitoren e Superkupës

# Bruno Zyka:

## Ja sa paguhem në Shqipëri, e shoh veten jashtë

*"Duartrokitjet e familjes kanë peshën e gjithë botës"*





Egla Xhemali

Pak muaj më parë ai mbajti në duar Superkupën e Shqipërisë, që u fitua nga Durrësi pas 60 vitesh. Në ndeshjen që u zhvillua mes këtyre dy qyteteve, Bruno Zyka u paraqit mjaft mirë dhe u lavdërua si ndër basketbollistët e rinj më të zot. Zyka vjen në një rrëfim ekskluziv për "Summer Pages" për të na zbuluar të fshehtat e botës së basketbollit, eksperiencat me skuadrat jashtë, për të mirat materiale që i sjell pasioni dhe profesioni i tij, motivimet si dhe planet që ka për të ardhmen. Për të kanë qenë të veçanta ndeshjet që ka luajtur me Kombëtaren kundër ekipeve Hungari, Austri dhe Greqi ku ka arritur rezultate të kënaqshme. Një tjetër moment që i ka dhuruar emocione të bukura ka qenë "Finalja e Kupës" në rajonin e Capania në Itali, ku është vlerësuar si lojtari i dytë më i mirë "Under u 20". Bruno pohon se një basketbollist nuk e ka rrogën shumë të lartë në bazë dhe të kushteve që vendos. Ai ka arritur deri këtu nëpërmjet punës intensive dhe familjes, që e ka mbështetur në çdo hap. Basketbollisti jep një këshillë për të gjithë ata që sapo i kanë hyrë botës së basketbollit, duke thënë se duhet shumë punë nëse duan të bëhen profesionistë. Zyka tregon se ka shumë miq dhe i pëlqen të udhëtojë. Ai qesh kur e pyesim për vajzën ideale, duke pranuar se do të donte që ajo të ishte e gjatë dhe t'i përkiste të njëjtit profesion. Sa u përket planeve që ka për të ardhmen, Bruno na thotë se do që të arrijë majat në nivelin e basketbollit evropian dhe se shumë shpejt do ikë nga Shqipëria për të vazhduar jetën që nisi në Itali.

**Sa pëlqehet basketbolli në Shqipëri?**

Le të themi që në Shqipëri basketbolli kohët e fundit është një sport në rritje, por gjithsesi mbetet sport jo parësor për nga rëndësia, duke qenë se më shumti njerëzit pëlqejnë futbollin.

**Si ka lindur dëshira për të luajtur?**

Dëshira ka lindur që në fëmijëri. Në moshën tetëvjeçare kam shfaqur interes për t'u përfshirë në aktivitete sportive. Duke vërejtur këtë gjë, prindërit më kanë shtyrë më shumë t'i hyja basketbollit. Aty e ndjeja veten goxha mirë dhe natyrisht që më vonë u kthye në pasion.

**Basketbollin e sheh si pasion apo profesion?**

Basketbollin e kam pasion, por kam fatin e madh që ai të jetë dhe profesioni im dhe për këtë i jam shumë falënderues Zotit. Besoj se asnjë punë nuk realizohet ashtu siç duhet, nëse nuk e nis me dëshirë. Për mua basketbolli ka qenë ëndrra e hershme e vegjëlisë, të cilën po e realizoj me përkushtimin çdo ditë. Nuk e di nëse do bëja më mirë diçka tjetër, pasi profesioni që kam zgjedhur më përfaqëson më së miri.

**Cila ka qenë ndeshja që e kujton më me shumë nostalgji?**

Kam kujtime për çdo ndeshje që kam luajtur, por një nga momentet që më ka dhuruar emocionet më të bukura ka qenë "Finalja e Kupës" në rajonin e Capania në Itali, ku aty jam vlerësuar si lojtari i dytë më i mirë "Under u 20".

**Ka pasur ndonjë moment ku ke dashur ta lësh basketbollin?**

Për çdo pasion që njerëzit kanë, ka një marrëdhënie dashuri-urrejtje dhe të them të vërtetën, ka pasur shumë momente ku jam mërzitur deri në pikën që të qëndroja larg fushave, por dashuria ime për këtë sport është mjaft e madhe, ndaj dhe vazhdoj të jem aktiv, duke shpresuar se ditë më të mira do vijnë dhe basketbolli do vlerësohet edhe më shumë në të ardhmen.

**Ke provuar të luash me skuadra brenda vendit dhe jashtë tij. Cili është ndryshimi?**

Kam pasur fatin që në moshën 16-vjeçare të provoja eksperienca me skuadra të nivelit profesional në Itali. Diferencat më të mëdha brenda dhe jashtë vendit janë në infrastrukturë dhe në kualifikimin e trajnerëve jashtë vendit.

**Sa paguhet një basketbollist?**

Basketbollisti paguhet gjashtëqind mijë deri në një milion lekë. Në ekipin e Superligës rroga shkon pesëqind mijë lekë. Kushtet lënë për të dëshiruar.

**Cila është këshilla që do u jepje atyre që sapo kanë nisur të luajnë basketboll?**

Do u drejtohem fëmijëve, pasi basketbolli nis që në moshë të vogël. Nëse basketbollin e shohin si pasion, duhet të punojnë shumë fort që të arrijnë të bëhen lojtarë të mirë profesionistë e të kenë mundësi pse jo të luajnë jashtë Shqipërisë. Të gjitha ndeshjet e zhvilluara përtej kufijve mbeten eksperiencat më të bukura për këdo që merret me sport.

**Si e nis ditën një basketbollist?**

Dita e një basketbollisti nis njësoj si dita e një personi të zakonshëm që nuk merret me sport. (qesh). Zgjohem në mëngjes, ushqehem, kryej të gjitha nevojat e mia dhe bëhem gati për stërvitjen e paradites. Pasi mbyll ditën, darka më gjen me miqtë e ngushtë. Në përgjithësi preferojmë të lëvizim anekënd dhe të eksplorojmë vende të reja.

**Sa të ka motivuar familja?**

Familja ka qenë një ndihmë shumë e madhe si nga ana financiare, ashtu edhe morale. Ata më kanë mësuar që për të

➔



# Tuna rikthehet me klip, lë pa fjalë me linjat



Tuna është një nga këngëtaret më të dashura për publikun shqiptar. Bukuroshja ishte tërhequr për më shumë se një vit nga muzika pas ardhjes në jetë të djalit të saj, Tianit. Para disa javësh Tuna lajmëroi të gjithë fansat se do rikthehej fuqishëm me një këngë. Këngëtarja publikoi disa foto në rrjetin social "Instagram", shkëputur nga videoklipi, ku duket më në formë se kurrë. Ajo gjithashtu i ka dhënë fund pritjes së ndjekësve duke publikuar këngën "Chonga", në të cilën duket mjaft seksi. Mesa duket, kjo këngë do kthehet në hit.



# Samanta Karavella pozon me të pasmet

Menjëherë pas publikimit, kënga e saj "Kush jam" rrëmbeu zemrat e dëgjuesve, duke e renditur ndër të parat e hiteve të verës. Samanta Karavella është një prej këngëtareve më joshëse shqiptare dhe kjo duket qartë edhe në postimet që bën në rrjetet sociale. Samanta ka ndarë një foto ku shënjestra e kameras kanë qenë të pasmet e saj bombastike. Këngëtarja duket mjaft seksi e veshur me xhinse.








← arritur atë çka do, duhet të luftosh. Asnjëherë nuk më kanë privuar duke e ditur dhe pjesën që unë nëse e nis diçka, doemos do e finalizoj me sukses. Duartrokitjet e tyre kanë peshën e gjithë botës. Këtë e kam vënë re sa herë që kam pasur ndeshje jashtë, kryesisht kur kam luajtur me skuadrat italiane dhe lëviznim shpesh. Dhe pse nuk kanë qenë pranë meje, suporti nuk më ka munguar kurrë.

**Cila është pika e dobët e Brunos?**

Natyrisht që është familja. Për ta jam i gatshëm të bëj gjithçka.

**Si është vajza ideale për ty?**

Thjesht mjafton të jetë e gjatë dhe t'i përkasë të njëjtit profesion si unë. (qesh)

Sa i shoqërueshëm është një basketbollist?

Në përgjithësi sportistët janë të shoqërueshëm. As unë nuk bëj përjashtim. Jam tip që kam shumë miq. Ndaj me ta gjithçka si dhe bëjmë shumë shaka.

A ndjen emocione para ndeshjeve?

Padyshim që ndjej emocione. Çdo ndeshje përjetohet ndryshe nga tjetra. E rëndësishme është të arrihet rezultati i dëshirueshëm, që të gjithë të ngelemi të kënaqur me paraqitjen.

**Çfarë ta zë kohën e lirë?**

Kohën e lirë më pëlqen ta kaloj me shoqërinë dhe familjen. Jam person që më pëlqen jeta dinamike, lëvizja. Preferoj shumë udhëtimet.

**Ku e sheh veten në të ardhmen?**

Sa i përket të ardhmes, synim kam që të arrij majat në nivel basketbolli evropian, po për momentin po i përkushtohem së tashmes. Jam stërvitur ndërkohë me skuadrën kombëtare, që ishte një eksperiencë e re për mua. Natyrisht që dua të iki sërish jashtë. Kam luajtur me skuadrat më të forta në basketboll në Itali, kam kaluar katër vite atje. U ktheva për një periudhë shumë të shkurtër këtu, po së shpejti do largohem përsëri.

# Vajza e ish-deputetes ' ndez' rrjetin




Vajza e ish-deputetes demokrate, Albina Deda ka "ndezur zjarrin" në rrjetet sociale. Modelja Ada Deda ka provokuar me pozat që ka ndarë me fansat. Ajo është duke pushuar dhe ndërkohë ka postuar në "Instagram" disa foto që nxjerrin në pah linjat e saj perfekte. Postimet e bukuroshes janë shoqëruar me komente nga më pozitivet.







# A doni të zgjateni edhe pak më shumë? Zbuloni se si



Thuhet se 20% e gjatësisë suaj përcaktohet nga faktorë të jashtëm, si dieta ushqimore, aktiviteti fizik dhe mjedisi. Kjo do të thotë se nuk duhet t'ia vini fajin vetëm gjenetikës. Dihet tashmë se njerëzit e gjatë kanë më shumë sukses në shoqëri dhe tërheqin më shumë vëmendjen e të tjerëve. Kjo shpjegon të gjithë vëmendjen që u kushtohet supermodeleve, basketbollistëve etj. Para se të vendosni të harxhoni para për të blerë ilaçe që thuhet se të zgjasin, lexoni disa mënyra natyrale që mund t'ju ndihmojnë të shtoni disa centimetra.

*HANI SHËNDETSHËM*

Dieta e shëndetshme ndihmon në zhvillimin dhe rritjen e trupit. Duhet të konsumoni ushqime të pasura me vitamina, minerale dhe vlera të tjera ushqyese që nevojiten për rritjen.

*QËNDRONI LARG VESEVE TË KËQIJA*

Konsumimi i alkoolit dhe qetësuesve ju pengojnë që të arrini gjatësinë maksimale. Kjo gjë ndodh pasi ata ndikojnë tek organet jetësore. Është shumë e rëndësishme që të shmangni stresin. Duhet të pushoni dhe flini mjaftueshëm, që t'i jepni mundësi trupit të rritet normalisht.

*USHTROHUNI RREGULLISHT*

Të qenit aktiv çdo ditë, sidomos kur jeni akoma të rinj, ju ndihmon të keni një shtat të lartë. Aktiviteti fizik dhe ushtrimet rregullisht luajnë një rol shumë të rëndësishëm në formimin e kockave dhe muskujve.

*BËNI JOGA*

Joga ndihmon për të larguar stresin, i cili pengon në rritjen e trupit. Duke bërë joga, ju gjithashtu humbni edhe disa kile, që ju bëjnë të dukeni më të shkurtër sesa jeni.

*MBANI TRUPIN GJITHMONË DREJT*

Mbajtja e shpinës drejt, edhe nëse jeni të ulur apo në këmbë, është e rëndësishme për zgjatjen e trupit. Qëndrimi jo i drejtë, jo vetëm që ju bën të dukeni më të shkurtër, por pengon edhe muskujt që të rriten më shpejt.

*KONSUMONI SA MË SHUMË UJË*

Për të përmirësuar tretjen dhe thithjen e vlerave ushqyese nga ushqimet, duhet të pini sa më shumë ujë.

*HANI SHPESH QË TË PËRSHPEJTONI METABOLIZIMIN*

Që të siguroheni se metabolizimi është gjithmonë duke vepruar, hani 5 deri 6 vakte në ditë nga pak, në vend të 3 vakteve të bollshme.

*MERRNI SA MË SHUMË DIELL*

Vitamina D tek dielli është shumë e rëndësishme për zgjatjen e trupit. Kjo vlerë ushqyese është e nevojshme për thithjen e kalciumit nga kockat, duke çuar kështu në rritjen e tyre.

## Adrenalina në maksimum, Presidenti Meta e nis ditën me sport ekstrem

Thuhet se 20% e gjatësisë suaj përcaktohet nga faktorë të jashtëm, si dieta ushqimore, aktiviteti fizik dhe mjedisi. Kjo do të thotë se nuk duhet t'ia vini fajin vetëm gjenetikës. Dihet tashmë se njerëzit e gjatë kanë më shumë sukses në shoqëri dhe tërheqin më shumë vëmendjen e të tjerëve. Kjo shpjegon të gjithë vëmendjen që u kushtohet supermodeleve, basketbollistëve etj. Para se të vendosni të harxhoni para për të blerë ilaçe që thuhet se të zgjasin, lexoni disa mënyra natyrale që mund t'ju ndihmojnë të shtoni disa centimetra.



## Manjani: Si është puna, Ramës i pëlqen pushteti ekstrem

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani ironizon duke u shprehur se presidentit i pëlqejnë sportet ekstreme, ndërsa kryeministrit pushteti ekstrem. "Si është puna! Presidentit i pëlqejnë sportet ekstreme, kryeministrit pushteti ekstrem. Të gjithë të tjerët duhet të gjejnë 'ekstremin' e tyre që u pëlqen. Nëse nuk e gjejnë, duhet të gëzohen për ekstremin e tjetrit. Asgjë normale... Ekstrem...", shprehet Manjani.



# BULEVARDI POLITIK

*Na merrni seriozisht!*

## Voltana "humor" shkodran, gjen "armikun" e fesë për posterat



Kryebashkiakja e Shkodrës, Voltana Ademi u kritikua ashpër për një poster të shpërndarë nga bashkia që ajo drejton, ku shfaqej minarja e thyer e xhamisë. Nuk dimë nëse ishte lapsus, por shumë qytetarë e interpretuan si fyerje për besimin e tyre. E si për të ndrequr gabimin, kryebashkiakja e Shkodrës postoi dje një video të myftiut të Tiranës, Ylli Gurra, që akuzon regjimin komunist për zhdukjen e librave fetare në bibliotekën e gjyshit të tij. Ndoshta ka dashur të na tregojë se kush janë armiqtë e vërtetë të fesë.




## Arushi ngjan me presidentin, Kina ndalon "Winnie The Pooh"

Kina ndalon "Winnie The Pooh". Ditët e fundit në kinematë botërore po shfaqet filmi për fëmijë "Christopher Robin", i cili bazohet në historinë e arushit Winnie, i njohur nga të gjithë fëmijët. Arsyeja e cila nuk është ende zyrtare, është se arushi i famshëm në të kaluarën është përdorur nga opozita në Kinë për të tallur presidentin e vendit, Xi Jinping. Në qershor të vitit 2013 presidenti kinez vizitoi presidentin Obama në Kalifroni dhe ndër titujt që morën më shumë vëmendje ishin ato që krahasonin dy presidentët me Winnie Pooh dhe tigrin, duke i treguar Xi dhe Obama në pozicione pothuajse identike.



KULTURE

Arkeologu francez, Léon Rey zbuloi në fillimin e viteve '30 në Apoloni, skulpturën me fytyrën e perandorit August

# Shqipëria,
## tokë ku shkelën perandorë



*"Dora zbulon mermerin dhe duke u dridhur, ajo ndjek shtegun që ka lënë dalta mbi të"*

Luan Rama

Kur arkeologu francez Léon Rey, zbulonte në fillimin e viteve '30 në qytezën antike të Apolonisë një nga skulpturat me fytyrën e perandorit August, i pari perandor i Romës, ai e kuptoi se kjo skulpturë e ngritur diku në mes të qytetit ishte jo vetëm një vepër arti e Akademisë së Artit të Apolonisë, por edhe një dëshmi e lidhjes së fuqishme që kishte pasur ky qytet me këtë perandor, i cili në rininë e tij kishte jetuar në shtëpitë e këtij qyteti. Përshkrimi i Rey-it gjatë një prej ekspeditave të përvitshme në Apoloni në ditarin e tij është interesant: "Dora zbulon mermerin dhe duke u dridhur, - shkruante ai, - ajo ndjek shtegun që ka lënë dalta mbi të. Ja tashmë tek qëndron, ashtu siç e ka krijuar vetë artisti. Burri i veshur me togën e madhe, duket sikur po zbret drejt qytetit që tashmë nuk ekziston më. Ai është i ri dhe i bukur. Vallë është Oktaviani, "Augusti" i ardhshëm, i cili bëri studimet në këtë qytet? Hipoteza duket tërheqëse…". Dhe disa ditë më pas, Rey gjeti një kokë tjetër mermeri në të cilën vërtetoi se ishte pikërisht e Oktavianit, pasi një e tillë, e ngjashme, me të njëjtën shprehje, ai e kishte parë në muzeun e Firences.

Ky personazh historik, është një nga figurat më të shquara të dymbëdhjetë çezarëve që flet historian romak Sueton në librin e tij Jeta e dymbëdhjetë çezarëve. Historianët e Republikës së Romës dhe më pas ata të Luftës Civile dhe të kohës imperiale, shkruajnë pak për kohën e qëndrimit të Augustit në Apoloni, i cili në atë kohë kishte emrin Oktavian. Oktaviani kishte lindur më 23 shtator të vitit 63, para erës sonë, në Romë, dhe prindërit e quajtën Caius Octavius Thurinus. Ai ishte biri i Atia-s, mbesës së Cezarit dhe i Gaius Octavius, i cili ishte guvernator i Maqedonisë së pushtuar në atë kohë nga ushtritë romake. Pas luftës në Maqedoni, bashkë me disa legjione, Çezari e dërgoi Oktavianin në Apoloni që të ndiqte Akademinë Ushtarake. Bashkë me të ishte dhe Agrippa, i cili do të bëhej më vonë një nga gjeneralët më të shquar të perandorisë augustiane. Por atëherë, Roma ishte ende Republikë. Ishte viti 45 para erës sonë dhe Apolonia bashkë me Dyrrachium-in, ishin dy nga qëndrat më të fuqishme të bregut të Ilirisë. Në rrethinat e Apolonisë, pak vite më parë, Çezari kishte ngritur kampin e vet dhe kur kishte hyrë në qytet, ushtarët e legjioneve romake, por dhe banorët e kishin brohoritur ardhjen e tij. Luftërat kundër legjioneve të Pompeut njihen, si ato në afërsi të Apolonisë ashtu dhe në rrethinat dhe kështjellën e Durrës, për të përfunduar pastaj në Farsale të Maqedonisë, ku Pompeu u mund plotësisht.

Oktaviani ishte veçse 19-vjeçar kur erdhi në Apoloni, në një kohë kur sapo kishte sprovuar luftërat e Maqedonisë. Por meqë nuk kishte fëmijë, Çezari mendonte gjithnjë që ta bënte trashëgimtarin e tij, prandaj dhe e dërgoi nipin e vet të përgatitej nga ana ushtarake, të ushtronte artin e kalorësisë dhe të mësonte strategjinë e luftës. Apolonia atëherë ishte një qytet i lulëzuar, të cilën e kishte vizituar dhe kishte qëndruar pak vite më parë Ciceroni, i cili e cilësonte atë "Magna urbis et gravis", ("Një qytet të madh e hijerëndë"). Krahas banorëve, apoloniatëve, në qytet ishin dhe krerët ushtarakë, guvernatori, magjistratët, etj., ndërkohë që forcat ushtarake ishin në kampet e ngritura në fushat që rrethonin qytetin. Imagjinoni një çast 80 mijë ushtarët e Çezarit, që kishin rrethuar qytetin prej pak kohësh, pamje që ndoshta sot e tejkalojnë imagjinatën tonë. Qyteti i Apolonisë kishte atëherë një Agonothet, siç e shohim një pjesë të tij, të zbuluar nga Rey dhe të ringritur nga arkeologët shqiptarë, (një pjesë e fasadës), disa dekada më parë. Po ashtu, ishte Odeoni, Buleterioni, banjat, Nimfeu, tempujt e ndryshëm, siç ishte dhe ai i Apolonit, Dianës, Demetras, etj. Monumentet e statujat e shumta të Erosit, Heras, Hermesit apo Meneadat, gjallonin rrugët me kalldrëm. Pllakat e mermerit ishin të mbushura me dedikime e mbishkrime të ndryshme. Në qytetin e ngrohtë e plot diell pranë detit, ishin sallat e hapura të muzikës, vendet e kultit, altarët në abside, kamaret dhe muret e trashë rrethues, akuaduktët që sillnin ujë, etj. Rrugët e Apolonisë gumëzhinin nga njerëzit, tregjet, prostitutat, (më të shumtat gjendeshin atëherë në Dyrrachium, i cili kishte një nam të madh për pasurinë e shumëllojshmërinë e tyre), pasi pranë Apolonisë ishte porti ku zbarkonin anijet që vinin shpesh nga Brindizi dhe qytetet e tjera të Mesdheut. Oktaviani, (apo Oktavi, siç e thërrisnin jo pak në atë kohë), ishte një djalosh shumë i bukur. Në librin për jetën e tij, historiani Sueton shkruan se "Ai kishte një bukuri të rrallë, bukuri të cilën e ruajti gjatë gjithë jetës… Sytë e tij ishin gjithnjë të gjallë e të shndritshëm, madje ai të bënte të besoje se shikimi i tij kishte diçka hyjnore. Kur u bë August dhe e fiksonte shikimin e tij tek dikush, ai kishte dëshirë që tjetri ta ulte kokën, si i verbuar nga dielli". Arkeologu francez Eric Follain, i cili kohët e fundit botoi në revistën franceze "Archeologia", një studim mjaft interesant për Apoloninë, ka krijuar dhe sjellë në faqet e kësaj reviste, pamje sintezë (disa prej të cilave po ribotohen këtu), se si kishin qenë në të vërtetë shumë prej ndërtesave kryesore të Apolonisë së asaj kohe, nga të cilat kanë mbetur veçse rrënoja, pasi gurët e tyre, siç na dëshmon në kujtimet e tij arkeologu Rey por dhe arkeologët e tjerë francezë si, Léon Heuzey apo Alfred Gilliéron, janë marrë me qerre nga pashallarët e Beratit për t'i përdorur për themelet e sarajeve të tyre. Po në këtë mënyrë u morën dhe gurët e tempullit të Dianës, një tempull tepër i veçantë në historinë e arkitekturës së asaj kohe, me gjashtë shtylla të mëdha dhe të larta, nga e cila në shekullin e XIX kishte mbetur vetëm një shtyllë, që me sa duket nuk kishin arritur ta shembnin, (ja pse dhe ai fshat që do të krijohej aty, më pas do të quhej Shtyllas). Sidoqoftë, në mes të qytetit ishte dhe obelisku i Apolonit, tempull të cilin Oktaviani e gjeti në Apoloni dhe kur ai u bë perandori i parë e Romës, një kopje e këtij tempulli u vendos në pallatin e tij, në Palatin.



Siç kishte legjionarët dhe magjistratët e tij, ky qytet kishte dhe skllevërit që mbanin me vete legjionarët, të cilët i ndiqnin nëpër ekspeditat e tyre. Siç shkruan historiani francez Pierre Cosme rreth Apolonisë së Ilirisë në librin Auguste, "Apolonia nuk ishte vetëm një qytet garnizoni ushtarak për trupat ku Cezari mendonte të niste ekspeditat e mëdha kundër dakëve dhe partëve. Edhe pse nuk kishte shkëlqimet e Athinës, Aleksandrisë dhe Pergamos, Apolonia ishte një qendër e kulturës, ku Oktaviani u shoqërua nga Apollodori i Pergamos…". Pikërisht në Apoloni, pohon ky studiues dhe biograf i Oktavianit, (August), "nipi i Çezarit njohu astrologun e famshëm Theogjen, i cili i parathotë Oktavianit një të ardhme të shkëlqyer dhe të jashtëzakonshme". Këtë informacion e kemi dhe nga historiani romak Sueton, i cili e shkruan këtë dhe në librin e famshëm të tij, ashtu si dhe nga shumë historianë të tjerë të kësaj epoke. Në librin e tij Hyjnori Auguste, Sueton shkruan se "Gjatë kohës së tij në Apolloni, bashkë me Agrippa-n, ai shkoi në observatorin e Théogène. Pasi dëgjoi dhe pa horoskopin e

← Agrippa-s, ai i tha se kishte përpara një të ardhme të shkëlqyer. Oktaviani nuk kishte folur për horoskopin e tij, nga frika, apo nga turpi se mos parashikimi i Théogène nuk do të ishte si ai i mikut të tij. Por pas nxitjesh të shumta dhe hezitimesh, Oktaviani i tregoi Théogène-it dhe ai u habit menjëherë për fatin që e priste atë. Më vonë, Auguste kishte një besim të jashtëzakonshëm në të ardhmen e tij, madje ai prodhoi monedha që kishin konstelacionin e lindjes së tij, atë të konstelacionit të dhisë". Në Apoloni, Oktaviani njohu dhe Mecenën, një figure tjetër e kësaj kohe, i cili do të bëhej këshilltari më i ngushtë i Oktavianit gjatë gjithë jetës së tij si konsull dhe pastaj si perandor. Ishte pikërisht ky Mecena, (nga vjen dhe termi i mecenatit, mecenëve të artit, etj.,), i cili e shtyu Augustin që ta shndërronte Romën në një qytet plot shkëlqime, duke i dhënë një impuls të jashtëzakonshme ndërtimeve të mëdha, ngritjes së tempujve, monumenteve, banjave publike, etj., aq sa në historinë romake, ku flitet për kohën e Augustit thuhet "shekulli i Augustit të shenjtë". Që nga ajo kohë ka mbetur shprehja: "Augusti e gjeti Romën me tulla dhe kur vdiq e la me mermerë të bukur". Apiani, nga ana e tij, në librin e tij "Histori romane-Luftërat civile" duke treguar për jetën e Oktavianit, shkruan se "Oktaviani, biri i vajzës së motrës së Cezarit, ishte bërë një 'hipparque' i Cezarit përgjatë një viti, sepse Cezari e kishte kthyer këtë funksion vjetor që të ushtrohej nga miqtë e afërt të tij. Oktaviani ishte ende djalosh kur u dërgua nga Cezari në Apolloni, në gjirin e detit Jon. Atij iu dërguan trupa e kuaj me qëllim që të stërvitej dhe shpesh oficerë të shumtë shkonin ta takonin meqë ishte i afërt i Cezarit. Ai i priste të gjithë me mirësjellje, çka forcoi miqësinë e tij me ata dhe me ushtrinë. Por gjashtë muaj më vonë, një mbrëmje, atë e lajmëruan se Çezari ishte vrarë në Senat nga ata që ishin miqtë më të shtrenjtë të tij dhe që ishin më të fuqishmit, pas tij".

Nga porti vinin dhe të rejat e Republikës. Pikërisht në ditët e marsit të vitit 44, një anije mbërriti në portin e Apolonisë dhe menjëherë në qytet u përhap lajmi se Çezari ishte vrarë nga Bruti, njeriu të cilin ai e mbante si një ndër më besnikët, aq sa, siç shkruajnë historianët, kur pa që Brutus i nguli thikën, Çezari i kishte thënë "Edhe ti biri im?" Padyshim që për Oktavianin ishte një lajm i tmerrshëm vrasja e Çezarit, i cili sapo e kishte proklamuar si trashëgimtarin e tij pas vdekjes, duke i lënë trashëgim gjithçka, me shpresë se pikërisht Oktaviani do të merrte në duar drejtimin e Romës dhe do të vazhdonte stafetën e lavdishme të tij. Por njëkohësisht me lajmin dhe konfuzionin që krijoi ky lajm në Apoloni, në datën 20-27 mars, Oktaviani i erdhi dhe një letër nga nëna e tij, Atia, e cila e porosiste që të mos nxitohej dhe të mos nisej për t'i bërë luftë vrasësve të Cezarit, por të qëndronte ca kohë në heshtje sa të qetësohej situata. Por nga ana tjetër, të gjithë oficerët e komandantët e legjioneve romake që ishin në Apoloni, vinin pranë Oktavianit dhe i kërkonin veçse shpagim, duke i premtuar besnikëri deri në vdekje. Por a do të mundte ai që të fitonte ndaj ushtrive të shumta që



kishin Mark Antoni dhe Bruti në Romë dhe në vendet e pushtuara si në Maqedoni e gjetkë? Agripa dhe miku tjetër Salvidienus Rufusi, një tjetër figurë e kohës imperiale, i kërkonin me këmbëngulje Oktavianit që ta linin Apoloninë menjëherë dhe të niseshin bashkë me legjionet drejt Brindizit, nëpër "Via Appia" e pastaj drejt Romës, me bindjen se dhe legjionet e tjera romake që do të ndeshnin rrugës, do të bashkoheshin me ta, meqë vrasja e Çezarit i kishte prekur të gjithë. Por këshilla e nënës ishte më e fortë sesa revolta e momentit. Ato net, kampet rreth qytetit ushtonin nga thirrjet për t'u nisur drejt luftës. Këtë moment të vështirë në jetën e Oktavianit e kujton dhe historiani Velleius Paterculus në librin e tij Historia romane : "Pas përfundimit të luftërave civile, Çezari e kishte dërguar në Apolonia që të mësonte disiplinat liberale dhe të zhvillonte talentet natyrore që kishte ky djalosh i ri i jashtëzakonshëm, në mënyrë që më pas, Çezari ta kishte si shok armësh në fushatën e mëvonshme kundër Gètes e më pas kundër Parthes. Kur mori vesh lajmin e vrasjes së dajës së tij, edhe pse "centurione"-t e legjioneve që ishin vendosur aty i premtuan ta mbështesin në luftën e tij; edhe pse Salvidienus dhe Agrippa i thanë që të pranonte kërkesat e tyre, ai nxitoi të shkonte në Qytet, (Rome), ku më së fundi mori vesh të gjitha detajet e vrasjes dhe e testamentit që i kishte lënë Cezari".

Më së fundi Oktaviani u nis, i shoqëruar nga miqtë e tij më të ngushtë, Agripa, Mecena, Rufusi si dhe disa legjione romake, të cilat e kishin shoqëruar dhe nga Maqedonia në Apoloni. Me vete kishte marrë dhe mësuesin e tij Apollodore, i cili ishte nëm oshë të thyer. Në ditët e para të prillit të vitit 44, ai mori anijet në portin e Apolonisë dhe u nis drejt Brindizit. Para vdekjes, i ati i kishte treguar Oktavianit se ditën që festonin fitoret e Çezarit, (Ludi Victoriae Caesaris), ai kishte parë një kometë. "Ajo kometë je ti biri im, që do të shkosh në botën e të shenjtëve", i kishte thënë i ati. Oktaviani po i drejtohej Romës, i vendosur për të mos bërë luftë. Vallë a do të realizohej parandjenja e të atit me atë kometë të shndritshme që kishte parë në qiell? A nuk i kishte thënë dhe astrologu Theogènen në Apoloni se ai do të bënte një karrierë të shkëlqyer dhe se e ardhmja e tij do të ishte e ndritur?



Kushedi… E megjithatë, parandjenja e atit të vdekur do të realizohej. Po si? Ç'ndodhi me Oktavianin më pas?... Seneka, në librin e tij "Historia natyrore", duke iu referuar kthimit të Oktavianit në Rome shkruan se "thuhet se ditën kur hyjnori Auguste u kthye nga Apolonia dhe hyri në qytet, (Romë), rrotull diellit u shqua një rreth



shumëngjyrësh. Këtë grekët e quajnë "halo", çka ne mund ta quajmë "kurorë të shndritshme".

Me të mbërritur në Romë, gjëja e parë që kërkoi Oktaviani ishte që të merrte trashëgiminë që i kishte lënë Çezari me testament. Pas kësaj, ai u afrua me Mark Antonin, me të cilin kishte luftuar në Maqedoni, por shumë shpejt ai u nda nga ai. I mbështetur nga Ciceroni, rreth vetes ai formoi një ushtri me të cilën luftoi kundër Mark Antonit në Modena, betejë ku vdiqën dy konsuj të Republikës. Ciceroni i propozoi Senatit që bashkë me të, të ishte konsull dhe Oktaviani dhe së bashku të drejtonin Republikën. Por për shkak të moshës së re, Senati nuk pranoi, edhe pse në luftën e Modenas, ushtarët, në ditën e fitores e kishin brohoritur si "Imperator". Meqë Senati nuk pranoi, i zemëruar, Oktaviani u bashkua sërish me Mark Antonin dhe pas pak kohësh pushtoi Romën, i dha fund Republikës dhe krijoi "Triumviratin" që do të ishte fuqia supreme. Pikërisht në atë kohë, njerëzit e Mark Antonit do të vrisnin Ciceronin që largohej i tmerruar nga Roma, por dhe Mark Antoni do të mundej disa vite më pas nga Oktaviani, në vitin 30 para erës sonë, në luftën detare të Aktumit në brigjet joniane. I kthyer fitimtar në Romë, për të shpërblyer kujtimin dhe ndihmën që i kishin dhënë apoloniatët në kohën e qëndrimit të tij atje, ai e shpalli Apoloninë "Qytet i lirë", pra pa taksa dhe i pavarur në njëfarë forme nga Roma, por gjithnjë aleate e saj. Dy vjet më vonë, në vitin 28, Senati e shpalli Oktavianin "Princeps senatu", (Senator i parë), dhe një vit më vonë e shpalli "August", (të Shenjtë), pra perandor.

Kur arkeologu franko-zviceran Alfred Gilliéron, (ashtu si më parë reverendi anglez Huges apo koloneli britanik Martin Leake më 1806), vizitonte Apoloninë në vitin 1869, nuk harron të flasë për kohën e lavdishme kur Augusti kishte studiuar artin ushtarak në Apoloni: "Përballë heshtjes mistike harroj që këtu ka qenë streha e studimeve të djaloshit Oktav, i cili ndoshta do ta kishte transformuar këtë kodrinë në një Akademi të Muzave"… Por mjerisht shekuj më vonë Apolonia do ta humbiste shkëlqimin e saj: lufëtrat, tërmetet, braktisja e qytetit, bënë që Apolonia të mbetej thjesht një vend kulti, por që në epokën otomane do të binte në një errësirë të plotë dhe do të rrënohej e përmbytej nga balta. Ata të huaj, konsuj, arkeologë, historianë e gjeografë që e vizituan në shekullin e XIX, mezi arritën të shohin veçse disa gjurmë që kishin mbetur nga koha e lavdishme e Oktavianit… Sekretet që fsheh Apolonia në vetvete janë ende të mëdha. Arkeologët e sotëm dhe ata të nesërm ndoshta do të na zbulojnë gjurmë të reja jo vetëm të Oktavian-Augustit, por edhe të bashkëluftëtarëve të tij të lavdishëm që jetuan në Apoloni, nga Ciceroni e më pas Bruti, Agripa, Mecena, Rufusi, prijësit e legjioneve të tmerrshme, etj., çka e bëjnë këtë tokë të Ilirisë së lashtë, këtë qytet të themeluar nga kolonitë greke të Korintit dhe Korkyrës që në shekullin e V-të para erës së re, një vend me "bëma të pagoja", pasi pjesa më e madhe e këtij qyteti shtrihet ende nën dhé…

Opinioni i Ditës

# Referim i gabuar

Nga Jorgji Kote

*(vijon nga faqja 1)*




...temperaturat politike me deklarimet për korrigjimin e mundshëm të kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në mbështetje të asaj teze të rrezikshme, në një prononcim të ditëve të fundit, ai iu referua edhe një ndryshimi në kufirin belgo-holandez.

Le ta sqarojmë konkretisht përse bëhet fjalë, meqenëse veç infove në web, e njoh këtë temë, sepse deri në prill 2017 isha këshilltar i ambasadës sonë në Bruksel.

Në juglindje të Belgjikës, në Provincën e Liezhit, pranë qytetit belg Visé, në kufi me Holandën është një mikrogadishull me një sipërfaqe sa 23 fusha futbolli.

Ky rezervat natyror u krijua pas viteve '60, për shkak të erozionit dhe devijimeve natyrore të lumit Meuse, që kalon në atë qytet; ai ishte praktikisht i padepërtueshëm dhe nga policia belge. Meqenëse për të kaluar nga territori holandez kërkohej autorizim dhe pastaj duhej t'i bije rreth e rrotull, policia belge dhe stafi i saj ndihmës (mjekë, laborantë, kriminalistë) mund të shkonin atje vetëm me barkë, një odise e vërtetë në mungesë të infrastrukturës përkatëse dhe me shumë mundime fizike mund të dilje në breg. Nga ana tjetër, policia holandeze nuk mund të ushtronte kontroll, pasi ai rrip toke ishte jashtë juridiksionit të saj.

Shkas dhe shtysë për ndërhyrje atje u bë shfrytëzimi i atij rezervati, që është e rëndësishme të theksojmë se ishte i pabanuar nga elementë kriminale, për prostitucion, drogë etj. Kambanat e alarmit për autoritetet belgo-holandeze ushtuan fort në vitin 2014, kur atje u gjet një kufomë njeriu pa kokë.

Kësisoj, filluan menjëherë bisedimet ndërmjet agjencive përkatëse të këtyre dy vendeve dhe në vitin 2016 u ra dakord për një këmbim territori ndërmjet tyre në po atë zonë, diku në mes të lumit Meuse. Mbi bazën e marrëveshjes përkatëse, Holanda përfitoi si kompensim një sipërfaqe prej 16 Ha, duke përfshirë edhe një pjesë toke me burime natyrore, ndërsa Belgjika u kënaq, 3,2 Ha, por u çlirua nga makthi i kontrollit mbi atë zonë.

Shihet qartë se kjo marrëveshje këmbimi apo korrigjimi territori, që hyri në fuqi më 1 janar 2018 u realizua sipas parimit "jep e merr" në kuptimin më të plotë të fjalës dmth., diku me humbje, diku me fitim, por në analizë të fundit të dyja palët dolën të fituara.

Faktet dhe faktorët e lartpërmendur tregojnë qartë se krahasimi apo referimi te ky shembull belgo-holandez në rastin e Serbi-Kosovë është fare pavend dhe krejtësisht i gabuar; qysh nga aspekti dhe sipërfaqja gjeografike, motivi, arsyeja e "korrigjimit" e sidomos sfondi historik i marrëdhënieve në rajon dhe elementë të tjerë.

Kufiri ndërmjet tyre është miratuar në vitin 1847 në Traktatin e Mastrihtit. Me gjithë uljet dhe ngritjet në raportet Belgjikë-Holandë, pas vitit 1944 brenda një kohe rekord ato u bënë bërë vende mike, aleate dhe partnere strategjike, bashkëthemeluese të BE-së, NATO-s dhe Beneluksit bashkë me Luksemburgun.

Në këtë klimë dhe mjedis lulëzues kanë ndikimin e tyre edhe lidhjet&krushqitë mbretërore, kryeministrat e rinj dhe me mentalitet liberal perëndimor, standardet e spikatura demokratike dhe zhvillimi i lartë socialekonomik. Formati dhe sidomos besueshmëria ndërkombëtare e Belgjikë/Holandë janë me shumë avantazhe edhe në politikën botërore me kontribute dhe ndihma konkrete në të gjitha fushat, zgjidhjen e konflikteve dhe pjesëmarrjen në operacionet ushtarake kudo në botë, përfshi edhe Kosovën; pa harruar bujarinë e tyre në pritjen dhe integrimin e miliona shtetasve të huaj dhe atyre shqiptarë.

Veç sa sipër, ky këmbim mikroterritoresh në Visè nuk u diktua nga ndonjë nevojë apo domosdoshmëri madhore e sigurisë në atë rajon, apo si kusht për integrimin në ndonjë organizatë ndërkombëtare; veç shqetësimit të agjencive ligjzbatuese, kurrfarë ndjeshmërie publike nuk kishte në atë rast. Ja pse korrigjimi në kufirin belgo-holandez filloi dhe përfundoi si një formalitet i thjeshtë, pa kurrfarë debati e polemike, edhe pse u deshën dy vjet për ta "kopsitur" edhe nga ana ligjore.

Krejt e kundërta ndodh me Serbinë. Me gjithë demarshet dhe përparimet në dialogun me Kosovën, falë kryesisht mbështetjes së SHBA-ve dhe BE-së, edhe tani, mbi 10 vjet pas pavarësisë, ajo nuk e njeh Kosovën, madje ajo po bën hapa prapa duke intensifikuar fushatën regresive për tërheqjen e njohjeve nga shtete të caktuara, diçka e paparë në praktikat diplomatike; ajo po saboton hapur anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare; ndërsa Frymën e Helsinikit, Procesin e Berlinit dhe bashkëpunimin rajonal po i përdor më shumë si dekor politik. Sa për miqësi Serbi-Kosovë dhe tani pas një periudhe të gjatë kohe, nuk mund të bëhet fjalë. Mirëpo siç pohon historiani i njohur ushtarak belg, Luc De Vos, duke iu referuar përvojës ndërkombëtare me plot shembuj negativë, "diferencën në çështjet kufitare e bën miqësia". Së fundi, siç përmendet sa herë me të drejtë, Kosova është rast "sui generis" pra krejt i veçantë. Ndaj, "zbulimi" mbi kufirin belgo-holandez, ndonëse në pamje të parë joshës, në fakt më shumë prish punë se sa "korrigjon" ndonjë gjë.



Opinioni i Ditës

# ‘Fake News’ - lufta mes së mirës dhe së keqes

Nga MONIKA STAFA

*(vijon nga faqja 1)*




...lajmit të rremë në "Facebook" dhe platforma të tjera mediatike, duke theksuar madje se kjo dukuri kish nxitur keqas edhe minimin e procesit politik në SHBA. Nëse nuk jemi seriozë mbi faktet dhe çfarë është e vërtetë apo jo, nëse nuk arrijmë të bëjmë dallime mes argumenteve serioze dhe propagandës, atëherë këtu ka një problem, pat thënë ai në një konference shtypi në Gjermani. Ishte nëntor i vitit 2016.

Që nga zgjedhja e papritur e Donald Trump si president i zgjedhur, "Facebook" është ndeshur me akuza të shumta lidhur me dështimin e tij në frenimin e rrjedhjes së keqinformimit publik. Ndër të tjera, edhe se modeli i tij i biznesit çon përdoruesit në ndarjen e dhomave të polarizuara politikisht. Që prej asaj kohe e deri tani, vala në rritje e raportimeve dhe e të dhënave mbi përhapjen e lajmit të rremë në media, keqinformimit, propagandës apo dhe alfabetizmit të lajmit vazhdon të jetë e pandalshme. Po cilët janë ato grupe njerëzish që janë të prirur të kenë tendencë për t'i besuar lajmit të rremë? Sa prej tyre i besojnë keqinformimit dhe cilët janë këto grupe? Cilës shtresë shoqërore i takojnë më së shumti? Dhe në çfarë pike duhet t'ia nisim edukimit medial dhe informimit në tërësi në shoqërinë tonë moderne?

Individët që paraqesin luhatje humori të shpeshtë dhe standarde të dyfishta komunikimi, apo edhe ata që kanë bindje radikale në besim fetar dhe politikë, janë ata individë të cilët kanë më shumë gjasa t'i besojnë lajmit të rremë. Këto grupe njerëzish kanë edhe një nivel intelekti më poshtë se mesatarja normale. Ky është rezultati që vjen pas një studimi më të fundit paraqitur në një konferencë shkencore ndërkombëtare në Universitetin e Yale-it, me disa ekspertë nga e gjithë bota. Besimi tek lajmi i rremë, u shprehën ata, shoqërohet pashmangshmërisht me nxitjen e madhe të projektimit të mashtrimit, të cilët këta individë u besojnë më syrin e parë.

Dy anketime cilësore ku u përfshinë rreth 1,000 pjesëmarrës sugjeronin se individët që mbështesin ide lidhur mashtrimin/paranojën, apo individët dogmatikë e me bindje fondamentaliste/radikale, kanë më shumë gjasa t'i besojnë lajmit të rremë.

Por përfundimet e anketave ndër të tjera flisnin për dy forma me të cilat mund të mbrohesh prej lajmit të rremë: së pari, të menduarit aktiv dhe hapur, që përfshin ndër të tjera edhe kërkimin e argumenteve alternative dhe rishikimin e provave për të arritur në përfundime. Së dyti, të menduarit analitik, i cili përfshin procese të menduari të qëllimshëm e që shkojnë deri tek rrënjët e kujtesës.

Reduktimi i të menduarit si proces, mbi këto forma logjikimi sjell pashmangshmërisht besimin në rritje te lajmi i rremë tek ata individë, të cilët mbështesin mashtrimin si ide dhe që qartazi ndihen të indoktrinuar prej dogmës/bindjeve fetare fondamentaliste apo që dallohen si radikalë. Por si mund të parandalohet rënia pre e këtyre njerëzve ndaj lajmit të rremë? Rezultatet e këtij anketimi nënkuptojnë se ndërhyrjet e projektuara për të nxitur mendimin aktiv dhe analitik mund të përdoren për të ndihmuar në parandalimin e efekteve dëmtuese të besimit në lajmin e rremë.

Gjatë këtij procesi studimor, hulumtuesit përdorën lojën e shahut me emrin Mechanical Turk, prej të cilit u krijuan dy grupe individësh prej 500 personash. Mechanical Turk është një makinë e rreme shahu, që u ndërtua në fund të shekullit të 18-të. Turku ishte në fakt një iluzion mekanik që lejonte një mjeshtër shahu të fshihej brenda për të operuar në makinë. Napoleon Bonaparti dhe Benjamin Franklin ishin burrat e shtetit që e frekuentonin më shumë. Pra, ashtu si në këtë lojë, hulumtuesve iu kërkua të vlerësonin saktësinë e 12 titujve të lajmeve të rreme, si dhe një sërë titujsh të tjerë të lajmeve të vërteta, duke u testuar mbi disa shkallë besueshmërie. Një prej pyetjeve madje ishte "A ndiheni ndonjëherë sikur ka një komplot kundër teje?". Dhe ata morën provën e reflektimit njohës. Pjesëmarrësit në grupin e dytë të individëve u lindi nevoja gjithashtu të merrnin edhe dy teste shtesë, sepse kjo do të thoshte se procesi i hetimit të këtyre gjetjeve, të pa nevojshme të vijonte me këtë procedurë. E gjitha kjo në vetvete rezultoi se njerëzit që "mbështesin idenë e mashtrimit" kanë më shumë gjasa të besojnë lajmin e rremë, psh., siç janë dhe "individët dogmatikë apo dhe fondamentalistët/radikalë, të cilët u besojnë bindjeve të fetare/politike". "Dobësia që këta individë tregojnë duke i besuar lajmit të rremë shpjegohet plotësisht prej tendencës së tyre për t'u angazhuar më pak në të menduarit analitik dhe më hapur", - citojnë rezultatin, autorët e studimit. Ky raport, i cili vjen në formë sugjerimi e vë theksin te ndërhyrjet e mundshme që mund t'i mbrojnë individët të bien pre e lajmit të rremë, duke shtruar kështu bazat për hulumtime të reja në këtë çështje në të ardhmen. Ky studim i fundit i Yale University mund të mërzisë shumë njerëz, por ajo çfarë ata duhet patjetër të mos heqin prej mendjeje para se të shkohet në përfundime të tilla emocionale, nuk janë inatet dhe mëritë që shkaktojnë këto perceptime por;

(i) lidhja reciproke vs shkak - Ky studim nuk po përpiqet të pohojë se të qënit i zhgënjyer, dogmatik, apo dhe fondamentalist në bindje ju bën të besoni në lajmin e rremë. Ajo që duket qartë si drita e diellit, është se këto gjëra së bashku tentojnë të bashkëveprojnë. Përsa i përket asaj se çfarë kjo gjë shkakton, nuk ka asgjë përfundimtare shprehen ekspertët. Ajo që ne po bëjmë, vazhdojnë ata, është paraqitja e provave rrethanore që mbështesin një histori, ku të qenit më pak i hapur dhe më pak reflektues çon automatikisht tek ky kompozim situatash - mashtrimi nëpërmjet informimit, besueshmëria tek ky lloj informimi dhe grupi që u beson (dogmatik, fondamentalist/radikal) duke shpjeguar disa ose të gjitha arsyet pse ato janë kaq të lidhur me njëri-tjetrin.

(ii) Hapësira e raporteve reciproke nuk është krahasimisht e madhe. Pra, nuk ka një teori të fundme që thotë "Oh, ju keni lëvizur shumë në shkallën e mashtrimit, që dmth. ju u besoni të gjitha lajmeve të rreme", ose "që ju jeni një fondamentalist/radikal, kështu që ju do t'u besoni të gjithë titujve të rremë". Pra, çdo gjë është relative, e duke qenë e tillë thonë ekspertët, me pak punë dhe vullnet hija e shfaqur mes keqinformimit të vazhdueshëm dhe propagandës mikluese, davaritet ngadalë. Por sigurisht kjo do edhe pak mirësi, tregojnë ata, duke buzëqeshur e me të tilla gjeste, duket sikur kanë rikonfirmuar atë parimin universal sa bota ka njohur jetë, se lufta mes së mirës dhe së keqes vazhdon.

E meqë e nisëm me presidentin Obama, kujtojmë se ai e pat shprehur me shqetësim të plotë para gazetarëve në Berlin atë që do të vinte më pas. Ne jetojmë në një epokë me kaq shumë keqinformime aktive dhe të paketuara kaq mirë, cilësonte ai në nëntor të 2016, sa është e pamundur të dallosh kur lexon të tilla histori, nëse je duke ndjekur "Facebook" apo TV. Dhe nëse çdo gjë do vazhdojë të duket sikur është e njëjta pa bërë të mundur të bëhen dallime, atëherë vërtet nuk do të dimë se çfarë duhet të mbrojmë. Dhe më keq akoma, nuk do të dimë për çfarë të luftojmë duke humbur aq shumë nga ajo çfarë kemi fituar në fushën e demokracisë dhe lirive të saj, ekonomive të mbështetura në tregun e lirë apo dhe prosperitetin që kemi marrë dhe dhënë, pat thënë ai.

## HOROSKOPI

### DASHI

Ndërsa shqyrtoni ditën tuaj ndërsa shikoni diellin dhe vëreni re, të cilat mbulojnë perspektivën tuaj. Sigurohuni që mendja juaj është në harmoni me zemrën. Mendoni për emocionet e ditës, mendimet dhe vëreni se si kanë ndikuar ato në veprimet tuaja.

### DEMI

Mendja po ju gumëzhin si një bletë dhe nuk e dini çfarë duhet bërë për ta ndaluar atë. Sigurohuni që të shtoni pak më shumë dhembshuri në zinxhirin që mban gjithçka bashkë. Gjithashtu sigurohuni që të mos bëheni viktimë e mendimeve tuaja.

### BINJAKET

Mëngjeset zakonisht nuk janë koha juaj më e mirë. Nuk jeni plotësisht zgjuar deri pasdite. Megjithatë, mundohuni të mos lini pas dore ngjarjet e këtij mëngjesi të veçantë. Disa surpriza parashikohen për ju.

### GAFORJA

Bota juaj mund të duket mjaft e ngushtë dhe e ngurtë këtë mëngjes, por lajmi i mirë është se vështirësitë janë të prirura të largohen teksa dita përparon. Gjërat mund të ndryshojnë në një çast.

### LUANI

Kjo është një nga ato ditë në të cilat keni dëshirë të ndaloni dhe të mendoni për ndjenjat dhe emocionet tuaja. Zemra juaj është e tejmbushur me dashuri ndaj një personi, i cili nuk përgjigjet në të njëjtën mënyrë.

### VIRGJERESHA

Përgatituni për një surprizë sot, ndoshta do të vijë nga dikush, por mund të jeni edhe ju që mund t'ia bëni dikujt. Sido që të jetë, në mbrëmje do të ndjeni mjaft dashuri. Kjo është koha juaj për të vepruar.

### PESHORJA

Gjërat duket se po shkojnë mjaft mirë për ju në shumë aspekte. Mendjen e keni të qartë, emocionet nën kontroll dhe pjesët e mistereve janë në rregull. Kjo është koha juaj për të përfituar nga ‘xhepat’ e fatit.

### AKREPI

Mekanizmi juaj i brendshëm mund të mos funksionojë si duhet sot. Shkak mund të jetë nevoja për t'u dhënë kuptim mendimeve tuaja si dhe të qartësoni emocionet. Përgjigja që kërkoni ndoshta do vijë gjatë orëve të natës.

### SHIGJETARI

Kini kujdes që të mos lodheni sot. Mund të keni nevojë për më shumë zell për të përmbushur qëllimet tuaja. Në të njëjtën kohë, jini të kujdesshëm në lidhje me sjelljen ndaj një personi në punë.

### BRICJAPI

Sot mund të jeni shumë nervoz kur të përballeni me disa të vërteta të hidhura. Adresojeni këtë problem menjëherë. Nuk është e nevojshme që të përpiqeni të fshihni ndjenjat.

### UJORI

Sot mund të përballeni me disa shkëndija dashurie që vijnë nga e kaluara. Ky shpërthim ndjenjash ka gjasa të godasë shpejt dhe papritur, prandaj mbani një sy hapur, por mos shpresoni se mund të zgjasë shumë.

### PESHQIT

Ndonjëherë emocionet u zënë vendin mendimeve racionale. Sot do të zbuloni se mendja dhe zemra juaj janë të lidhura me çështje të rëndësishme dhe koordinohen mirë së bashku. Qëllimi juaj është të gjeni bilancin më të mirë.





Pamje nga shpërthimi i autocisternës në Bolonja

### Italia në alarm, bilanci i personave që u prekën nga aksidenti i rëndë

# Shpërthen autocisterna në Bolonja, 2 të vdekur e 67 të plagosur

## Shtëllunga të mëdha tymi në aeroport, rrëzohet ura e qytetit

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur ditën e djeshme, ku pas shpërthimit të një autocisterne në zonën Borgo Panigale, në Bolonja bilanci i njerëzve të prekur sa vjen e rritet. Shpërthimi ka lënë të vdekur dy persona, ku njëri prej tyre ishte një 55-vjeçar dhe ka plagosur 67 të tjerë, 14 prej të cilëve në gjendje të rëndë raportojnë mediat italiane. Në mesin e të plagosurve janë edhe 11 karabinierë dhe dy policë rrugorë. Shpërthimi i autocisternës ndodhi pranë aeroportit të Bolonjas, rreth orës 14:00. Si pasojë e shpërthimit, një pjesë e urës së Bolonjës është rrëzuar. Një prej mjeteve të përfshira në aksident, një autocisternë që transportonte lëndë djegëse mori flakë dhe shpërtheu në vend. Rruga tashmë do të qëndrojë e mbyllur për sa kohë të nevojitet për rikonstruksionin e saj. Drejtuesve të mjeteve të bllokuar në radhë u janë shpërndarë shishe uji të ftohtë, për shkak të temperaturave të larta. Shpërthimi ishte aq i fortë sa shtëllungat e zjarrit dukeshin nga të gjitha anët e Bolonjës. Si pasojë e shpërthimit edhe disa makina janë përfshirë nga flakët. Autostrada e Casalekios është bllokuar nga të dyja anët dhe në vendngjarje ndodhen një numër i madh ambulancash. Zjarrfikës të shumtë kanë ndërhyrë, ndërsa në ndihmë është thirrur edhe një helikopter për të frenuar përhapjen e flakëve. Pas disa shpërthimeve, flakët u përhapën shpejt edhe te makinat buzë rrugës, duke shkaktuar zjarr zinxhir. Gjithashtu u shemb pjesërisht një urë në autostradë, në mbikalimin Casaleçhio A1-A14, raportojnë mediet italiane. Zjarrfikësit janë duke monitoruar flakët dhe po punohet edhe nga ajri për shuarjen e tyre. Ngjarja ndodhi dje në orën 13.40, mes daljes 2 dhe 3 të unazës në periferi të Bolonjës, në rrethin Borgo Panigale. Sipas raportimeve, thuhet se cisterna ishte duke transportuar eksploziv. Shuarja e flakëve u bë akoma më e vështirë nga temperaturat e larta. Për shkak të shpërthimit raportohet gjithashtu se dritaret e disa shtëpive buzë rrugës kanë shpërthyer. Ndërkohë, një helikopter ndërhyri nga ajri për të shuar flakët e zjarrit.



Pamje nga shpërthimi i autocisternës në Bolonja

**BILANCI**

Dy të vdekur dhe 67 të plagosur është bilanci i shpërthimit të një autocisterne në Bolonja të Italisë. Njëri prej personave që ka humbur jetën ishte një 55-vjeçar ndërsa ndër 67 të plagosurit, 14 prej tyre janë në gjendje të rëndë, raportojnë mediat italiane. Në mesin e të plagosurve janë edhe 11 karabinierë dhe dy policë rrugorë.

### Përplaset fugoni me kamionin, humbin jetën 12 persona

## Itali/ Aksident i rëndë në Foggia, kamioni përplas furgonin me emigrantë afrikanë

Ditën e djeshme ka ndodhur një aksident i rëndë automobilistik në Foggia të Italisë, ku kanë humbur jetën 12 persona, ndërsa 3 të tjerë janë plagosur. Ngjarja ndodhi në kryqëzimin e Ripalta-s. 'Tgcom' shkruan se viktimat janë emigrantë, që punonin në bujqësi, të cilët po ktheheshin nga puna. Emigrantët afrikanë po udhëtonin me një furgon me targa bullgare, ndërsa po ktheheshin nga fushat e mbjella me domate, i cili



u përplas me një kamion. Kamioni me të cilin u përplasën mësohet se transportonte miell. Ndërkohë që ende nuk dihen rrethanat e aksidentit të ndodhur. Ndërsa të shtunën e kaluar ndodhi një tjetër aksident i rëndë në rrugën dytësore midis Ascoli Satriano dhe 'Castelluçio dei Sauri', ku humbën jetën 4 punonjës, të gjithë emigrantë, si dhe u plagosën 4 të tjerë.



# Përgjaket ishulli Lombok, mbi 140 vdesin nga tërmeti në Indonezi

Ditën e djeshme kanë humbur jetën mbi 140 persona pas një tërmeti të fortë që goditi ishullin Lombok në Indonezi. Qindra vetë kanë mbetur të plagosur, pjesa më e madhe në veri të ishullit. Tërmeti me magnitudë 7 dëmtoi mijëra ndërtesa dhe ndërpreu energjinë elektrike. Rreth një mijë turistë të huaj janë evakuuar nga disa ishuj të tjerë aty pranë. Njerëzit e zënë nga paniku janë larguar menjëherë nga shtëpitë e tyre duke bërtitur. Fillimisht autoritetet edhe alarmi për cunam, por më pas e anuluan atë. Tërmeti i së dielës erdhi një javë pas një tjetër tërmeti që goditi ishullin Lombok, një vend shumë popullor turistik i njohur për plazhet e tij dhe si pasojë 16 persona humbën jetën. Tërmeti u ndje edhe në Bali. Ishulli Lombak dhe Bali kanë një popullsi prej 3-4 milionë secila, por çdo vit vizitohen nga miliona turistë nga e gjithë bota. Indonezia është e prirur për tërmete, sepse shtrihet në Unazën e Zjarrit, linjën që përshkon të gjithë oqeanin paqësor. Në këtë pjesë ndodhin shpesh edhe shpërthime vullkanike.

## Fjalëkryqi (1)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | | ■ | 3 | ■ | 4 | 5 | ■ | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| 11 | | ■ | 12 | | 13 | | | 14 | ■ | 15 | | | |
| | ■ | 16 | | | | | | | 17 | | ■ | 18 | |
| 19 | 20 | ■ | ■ | 21 | | | | | | | 22 | ■ | |
| ■ | | ■ | 23 | | | | ■ | ■ | 24 | | | | ■ |
| ■ | 25 | | | ■ | | ■ | 26 | ■ | 27 | | | ■ | 28 |
| 29 | | ■ | 30 | | | ■ | 31 | 32 | | ■ | 33 | 34 | |
| ■ | 35 | 36 | | ■ | | ■ | 37 | | | | | | |
| 38 | | | ■ | 39 | ■ | 40 | | | | ■ | 41 | | |
| 42 | | ■ | 43 | | 44 | ■ | 45 | | ■ | 46 | | ■ | |
| | ■ | 47 | | | | | | ■ | 48 | | ■ | 49 | |
| 50 | | | ■ | 51 | | ■ | 52 | | | ■ | 53 | | ■ |

HORIZONTAL
1. Steiger aktor.
4. Mbetet në fund.
6. Ustinov i kinemasë.
11. Janë në modë.
12. Nuk e shqyen Danielin.
15. Një as i Milan.
16. Çobani aktore e jona.
18. I dyti në kapitull.
19. Dy asa në dorë.
21. Qe njeriu i parë që u dënua padrejtësisht.
23. Croft e Angelina Jolie.
24. Një që mbahet për mondan.
25. Para De Janeiro-s.
27. Gjysmë tandem.
29. Kap ndryshe.
30. Gjysmë tatimi.
31. Union Stutendor Operativ.
33. Wallach aktor.
35. Pak spiunazh.
37. Ishin hipokritët e Jezu Krishtit.
38. Ai dhe ajo.
40. Një Madame e Maupassant.
41. Kështu thirrej Ernesto Guevara.
42. Fund ditari.
43. Pije piratesh.
45. Kush e thotë refuzon.
46. Të parat në sondazh.
47. Një makinë franceze.
48. Fillojnë stafetën.
49. Nisin nga fillimi.
50. Qan te Turandot.
51. Fundi i një samurai.
52. Umberto qe shkroi Lavjerësi i Foucault.
53. Dalë në krye.

VERTIKAL
1. Ajo e tretë u quajt Moska.
2. Në hyrje të odës.
3. Me mea për të penduarin.
4. Para... Gay në aeroplanin që hodhi bombën atomike në Hiroshima.
5. Jepet për hartim.
7. Lindi edhe Cerberin.
8. Mbyllin pora.
9. Gjysma e ekipit.
10. N jë inkursion me mig.
12. Fillojnë lehtë.
13. Eshtë tretës me zorrë.
14. Pak tematike.
17. Qe mbreti jetëgjatë i Pilos.
20. Eshte ndalim me pranga.
22. Shkroi Këngëtarja tullace.
23. Është pikë vaji.
26. Ndajnë shtetet.
28. Kush nuk ka... s'është njoftuar.
32. Poetja e Lesbos.
34. Kështu shprehet komisari Rex.
36. Fillojnë panikun.
38. Një liqen i kripur.
39. Inva soprano.
43. Inicialet e Altman
44. Një fjalë për sipër.
46. Të parat në stadium.
47. Fillojnë turnin.
48. Në hyrje të sokakut.
49. Fillojnë nazet

## Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
3. Një pune... paguhet.
6. Para Zeppelin në grupin e famshëm.
8. Vincenzo, bomber te Roma.
12. Kufijtë e pritjes.
13. Një Arthur i Edgar Allan Poe.
16. Demek s'ka kufij.
18. Qe filozofi i shkollës eleatike.
19. Nino, kompozitor i famshëm italian.
21. Është ai që ka ngrityr krye.
23. Finlanda e... finlandezëve.
25. Mbledh baskët separatistë.
26. Inicialet e Prost.
28. Shkroi Cockteil party.
29. Titulli i Alex ferguson.
30. Stile pa kufij.
32. Ishin greket që nuk vinin kurrë.
35. Unë dhe ti.
36. Hoxha që qe arbitër.
38. Është provë zjarri.
39. Majtas në fund.
41. Agjenci Ajrore Tiranë.
42. Është partia e Ariel Sharon.
43. Një mund të jetë çiklistik.
45. Të parat në sondazh.
46. E famshme ajo e psherëtimave.
47. Qendër ditore.
48. Një Baba përrallor.
49. Mund të jetë proteste.
50. Në fund të fundit.

VERTIKAL
1. Camille, indulgjenti që krijoi Vieux Cordelier.
2. Në krye të solistëve.
3. Janë poetë si Ungaretti.
4. Ylli më i shndritshëm i Demit.
5. Janë kopjet si delja Dolly.
7. Një pjesë e dimensioneve.
8. Fillojnë muzikën.
9. Parafjala e prejardhjes.
10. Fernando, bomber i Liverpool.
11. Bisha aktore.
12. Ishin ushtarë të Kserksit.
14. Partia Demokratike.
15. Cepat e një ylli.
17. Ylli i baletit.
20. Pak amoralitet.
22. Mbushin enë pa fund në ferrin dantesk.
24. Italia në Internet.
27. Përhapet me frikë.
31. Mund të jetë françeskan.
33. Dehin pa kufij.
34. Është lënda për... rafte.
37. Gjysmë sahati.
39. Tatum që qe pianist.
40. Lloj papagalli.
42. Një pikë vaji.
44. Artikull spanjol.
45. Në krye të socialistëve.

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ■ | 1 | ■ | ■ | 2 | ■ | ■ | 3 | 4 | 5 | ■ | 6 | | 7 |
| ■ | | ■ | 8 | | 9 | 10 | | | | 11 | ■ | ■ | |
| 12 | | ■ | | ■ | 13 | | | | | | 14 | 15 | |
| 16 | | 17 | ■ | 18 | | | | | | | | | ■ |
| 19 | | | 20 | ■ | ■ | 21 | | | | | ■ | ■ | 22 |
| 23 | | | | 24 | ■ | 25 | | | ■ | 26 | 27 | ■ | |
| 28 | | | | | ■ | 29 | | | ■ | ■ | | ■ | |
| 30 | | | ■ | ■ | 31 | ■ | 32 | | | 33 | | 34 | |
| ■ | 35 | | ■ | 36 | | 37 | | | ■ | 38 | | | |
| 39 | | ■ | 40 | ■ | 41 | | | ■ | 42 | | | | |
| | ■ | 43 | | 44 | | | ■ | 45 | | ■ | 46 | | |
| 47 | | ■ | 48 | | | ■ | 49 | | | | ■ | 50 | |

## Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigjia, ja cilat janë ndryshimet e figurave

## SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | | | 2 | | 4 | 8 | | |
| 2 | | | | | | 3 | | 9 |
| | 5 | | | | | | | |
| | | | | | 6 | | | |
| 4 | 6 | | | 1 | | | 9 | 3 |
| 9 | 8 | | | 4 | 7 | | | |
| 8 | | | | | | | 1 | |
| | | | | 6 | 2 | | | |
| | 7 | | | 3 | 5 | | 4 | |

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 3 | 5 | 8 | 4 | 6 | 2 | 9 | 7 |
| 6 | 7 | 4 | 3 | 9 | 2 | 5 | 8 | 1 |
| 8 | 9 | 2 | 1 | 5 | 7 | 3 | 4 | 6 |
| 2 | 8 | 9 | 4 | 1 | 3 | 6 | 7 | 5 |
| 3 | 4 | 7 | 5 | 6 | 8 | 1 | 2 | 9 |
| 5 | 6 | 1 | 7 | 2 | 9 | 4 | 3 | 8 |
| 7 | 1 | 8 | 6 | 3 | 4 | 9 | 5 | 2 |
| 9 | 5 | 3 | 2 | 8 | 1 | 7 | 6 | 4 |
| 4 | 2 | 6 | 9 | 7 | 5 | 8 | 1 | 3 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

## Argëtim filozofik

- Pothuajse të gjithë ateistët kanë argumente për bindjet e tyre. Pothuajse asnjë fetar nuk ka argumente për bindjet e tij.
- Ai që ka një mijë miq, shumë herë përpiqet për ti gjetur ata. Ai që ka një armik, e gjen kudo.
- Përvoja është një mësues i keq, sepse së pari ju vë në provë dhe pastaj ju jep një mësim.
- Lavdia është si rrethi në ujë. Vazhdimisht zgjerohet deri sa humbet.



## KRIPTOSKEME

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | 15 | 3 | 6 | ■ | 4 | 6 | ■ | 6 | 1 | 4 | 1 | 7 | T |
| 1 | 15 | ■ | 11 | 8 | ■ | 8 | 6 | ■ | 5 L | 3 I | 6 M | 1 A | A |
| 17 | ■ | 14 | 8 | 5 | 8 | 12 | 1 | 7 | 8 | 7 | ■ | 5 | K |
| ■ | 6 | 3 | 7 | 9 | 6 | 1 | 13 | 8 | 7 | ■ | 14 | 8 | ■ |
| 17 | 9 | 6 | 19 | 13 | 3 | 7 | 3 | 7 | 3 | 7 | ■ | 13 | K |
| 9 | 16 | 8 | 15 | 1 | 7 | 9 | 15 | 8 | 7 | ■ | 7 | 7 | O |
| 6 | ■ | 13 | 3 | ■ | 8 | 13 | 9 | ■ | ■ | 12 | 1 | ■ | M |
| 16 | ■ | 4 | 13 | ■ | 13 | 3 | ■ | 6 | 1 | 5 | 5 | 3 | P |
| 1 | 6 | 3 | 1 | 13 | 7 | ■ | 17 | ■ | ■ | 9 | 4 | 8 | A |
| 13 | ■ | 9 | 7 | ■ | 8 | 17 | 3 | 16 | 9 | 15 | 8 | ■ | N |
| 3 | 7 | 13 | ■ | 8 | 7 | 3 | 5 | 8 | 13 | 3 | ■ | 8 | I |
| 1 | 5 | 3 | 11 | 3 | ■ | 4 | 3 | 15 | 7 | 1 | 17 | 3 | A |

## KRIPTOSKEME

*Përgjigja e numrit të djeshëm*

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| T | R | I | M | ■ | S | M | ■ | M | A | S | A | T |
| A | R | ■ | B | E | ■ | E | M | ■ | L | I | M | A |
| K | ■ | D | E | L | E | G | A | T | E | T | ■ | L |
| ■ | M | I | T | O | M | A | N | E | T | ■ | D | E |
| K | O | M | U | N | I | T | E | T | E | T | ■ | N |
| O | P | E | R | A | T | O | R | E | T | ■ | F | T |
| M | ■ | N | I | ■ | E | N | O | ■ | ■ | G | A | ■ |
| P | ■ | S | N | ■ | N | I | ■ | M | A | L | L | I |
| A | M | I | A | N | T | ■ | K | ■ | ■ | O | S | E |
| N | ■ | O | T | ■ | E | K | I | P | O | R | E | ■ |
| I | T | N | ■ | E | T | I | L | E | N | I | ■ | E |
| A | L | I | B | I | ■ | S | I | R | T | A | R | I |

## PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

### FJALEKRYQI (1)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| F | ■ | A | U | T | O | P | O | R | T | R | E | T | ■ |
| A | S | T | R | I | D | ■ | K | O | R | E | ■ | E | K |
| R | H | T | ■ | ■ | ■ | C | ■ | B | E | P | ■ | M | A |
| A | K | ■ | M | A | R | A | T | O | N | A | ■ | A | P |
| D | O | N | A | T | O | R | E | T | ■ | R | I | T | A |
| ■ | P | I | R | A | T | I | ■ | I | E | T | ■ | ■ | C |
| K | I | N | E | M | A | T | E | ■ | T | E | R | R | I |
| R | ■ | I | T | A | ■ | A | ■ | M | E | T | R | A | T |
| I | ■ | V | E | N | U | S | ■ | B | ■ | ■ | ■ | V | E |
| J | O | E | ■ | E | R | ■ | P | E | T | A | L | E | T |
| I | D | ■ | A | T | I | K | A | ■ | E | M | I | L | E |
| M | A | T | A | ■ | M | I | N | A | R | E | T | ■ | T |

### FJALEKRYQI (2)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P | I | E | R | ■ | V | ■ | M | A | R | A | T | ■ | B |
| E | R | A | ■ | M | E | Z | O | N | E | ■ | ■ | M | A |
| R | E | ■ | M | I | R | E | L | ■ | ■ | O | M | ■ | R |
| I | N | A | ■ | K | O | L | O | N | I | T | E | ■ | I |
| P | E | R | S | E | R | I | T | E | S | I | T | ■ | T |
| A | ■ | T | E | L | E | G | O | N | I | ■ | O | P | O |
| T | R | E | N | ■ | T | ■ | V | ■ | ■ | A | N | E | N |
| E | M | R | A | T | ■ | Z | ■ | K | O | M | E | T | E |
| T | ■ | I | T | ■ | M | A | N | E | T | ■ | M | A | T |
| I | ■ | A | O | R | ■ | N | A | T | E | ■ | I | L | ■ |
| K | D | ■ | R | O | M | A | N | ■ | R | ■ | A | E | K |
| E | U | R | E | K | A | ■ | A | T | O | M | ■ | T | U |

## Thënie të mençura

- Kur "qan" një ikonë bizantine, të gjithë nxitojnë ti afrohen asaj. Pyes veten se sa e bëjë të njëjtën gjë kur qan një njeri?
- Nëse ju gjithmonë thoni të vërtetën, nuk keni nevojë të mbani mend atë që keni thënë.
- Liria e një personi duhet të arrijë deri aty sa që mos të shkeli lirinë e të tjerëve.
- Nëse ti bën një gabim, pranoje atë. Nëse nuk e pranon, sapo bëre një të dytë.
- Arsyeja se pse njerëzit ta marrin mirësinë për dobësi, është se ti je duke i'u dhënë shumë, më shumë seç meritojnë.




www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

Gazeta e gjithë shqiptarëve!




Kontakt: +355 68 40 63 842

Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube Youtube: Gazeta Shqiptare

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!




www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al